

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.  
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.  
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZIŠTA A.D.



# RAPORT VJETOR 2008



Prill 2009



# PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave dhe akronimeve	4
Lista e tabelave dhe grafikoneve	6
Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës	8
<b>I. KOSTT sh.a</b>	<b>9</b>
Fjala e Drejtorit Menaxhues të KOSTT sh.a	10
Fjala e Zëvendës Drejtorit Menaxhues për Zhvillim	12
Fjala e Zëvendës Drejtorit Menaxhues për Operim	12
Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2008	13
Anëtarët e Bordit të Drejtorëve 2006-2008 japin shkurt vlerësimet e tyre për KOSTT	13
KOSTT në numra	14
Qeverisja Korporative dhe Korniza rregullative e re nën të cilën vepron KOSTT	15
Objektivat e kompanisë për vitin 2008	15
<b>II. Operimi i Sistemit të Transmisionit</b>	<b>16</b>
Rëndësia dhe pozita e sistemit të transmisionit të Kosovës	17
Kapacitetet e rrjetit të transmisionit	17
Funksionimi i sistemit të transmisionit gjatë vitit 2008	18
Matjet	20
Humbjet	20
Mirëmbajtja	21
Telekomunikimi në Sistemin e Transmisionit	24
Sistemi SCADA / RTU	24
Mbrojtja dhe siguria në punë	24
Mbrojtja e ambientit	25
<b>III. Menaxhimi i energjisë elektrike gjatë vitit 2008</b>	<b>26</b>
Konsumi	28
Rrjedhat e energjisë “prodhim-transmetim-distribucion -konsumatori i fundit”	30
<b>IV. Funksionimi i tregut të energjisë elektrike</b>	<b>32</b>
Energjia e shitur tregu i realizuar	33
Importi dhe eksporti me koston e realizuar dhe krahasimet me tregun regjional dhe tregjet e tjera	33
Problematika e balancimit nga aspekti komercial i tregut të energjisë	34
Transiti i energjisë elektrike, shfrytëzimi i kapaciteteve të interkoneksionit dhe problematika që e shoqëron	35
Bashkëpunimi ndërkombëtar	37
<b>V. Projektet dhe investimet në Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës</b>	<b>38</b>
Plani i Zhvillimit të Rrjetit të Transmisionit	39
Projektet dhe investimet në Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës	39
Investimet në avancimin e Sistemit të Transmisionit	40
Projektet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2008	40
Rezultatet e arritura 2008	41
<b>VI. Organizimi i brendshëm dhe kapacitetet njerëzore</b>	<b>42</b>
Të dhënat e burimeve njerëzore të KOSTT për vitin 2008	44
Ngritja e kapaciteteve të ekspertizës në KOSTT	45
<b>VII. Tarifat e shfrytëzimit të shërbimeve të transmisionit dhe Pasqyrat Financiare</b>	<b>46</b>
Metodologjia e Tarivave të Kycjes në Rrjetin e Transmisionit	47
Parimet e Tarifimit	48
Metodologjia Hibrid	48
<b>Pasqyrat financiare</b>	<b>49</b>
Raporti i Auditorit të Pavarur	50
Ngjarjet 2008 që kanë karakterizuar punën e KOSTT sh.a	56

# Lista e shkurtesave dhe akronimeve

<b>A</b>	Amper
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BKK</b>	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
<b>Ct</b>	Kapaciteti i Bartjes
<b>DSO</b>	Operatori i Sistemit të Distribuimit
<b>EJL</b>	Evropa Juglindore
<b>EMS</b>	Elektromrezha Serbije / Transmisioni i Serbisë
<b>ENTSO-E</b>	European Network of Transmission System Operators for Electricity/Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike
<b>EPS</b>	Elektroprivreda Serbije / Elektroekonomia e Serbisë
<b>F</b>	Gjinia femërore
<b>HC</b>	Hidrocentral
<b>HMI</b>	Human Machine Interface
<b>HVM</b>	High Voltage Metering/Matjet e tensionit të lartë
<b>ISO</b>	International Organization for Standardization/Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
<b>ITC</b>	Inter TSO Compensation / Kompenzimi ndër OST
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KL</b>	Kualifikimi i lartë
<b>KOSTT</b>	Operator Sistemi Transmisioni dhe Tregu
<b>kV</b>	Kilovolt
<b>kW</b>	Kilovat
<b>kWh</b>	Kilovat-orë
<b>L</b>	Gjatësia e linjave
<b>LP</b>	Largpërçues
<b>M</b>	Gjinia mashkullore
<b>MEM</b>	Ministria e Energjisë dhe Minierave
<b>MEPSO</b>	OST-ja e Republikës së Maqedonisë
<b>MVA</b>	Megavat-amper
<b>NP N</b>	dërmarrje publike
<b>OPCG</b>	OST-ja e Republikës së Malit të Zi
<b>OPGW</b>	Lidhjet telekomunikuese të cilat operojnë me sistemin fiber-optik
<b>OS</b>	Operator i sistemit
<b>OST</b>	Operator i Sistemit të Transmisionit
<b>PK</b>	Përgatitja e ulët profesionale
<b>PL</b>	Përgatitja me shkollë të lartë

<b>PMP</b>	Përgatitja e mesme profesionale
<b>PSP</b>	Përgatitja superiore profesionale
<b>PZhST</b>	Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit
<b>QD</b>	Qendra Dispeçerike
<b>SEE</b>	Sistemi Elektroenergjetik
<b>SETSO</b>	South Europe TSO's/OST-të e Evropës Jugore
<b>SKK</b>	Standardet Kosovare të Kontabilitetit
<b>SNRF</b>	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
<b>SSH</b>	Stabilimente shpërndarëse
<b>TC</b>	Termocentral
<b>TL</b>	Tension i lartë
<b>TLF</b>	Transmission Loss Factor / Faktori i humbjes së transmisionit
<b>TNDP</b>	Plani Zhvillimor dhe Investiv i Transmisionit
<b>NS</b>	Nënstacion elektrik (Trafostacion)
<b>TSO</b>	Transmission System Operator/Operator i Sistemit të Transmisionit
<b>UCTE</b>	Union for Coordination of Transmission of Electricity/Unioni për Koordinimin e Transmisionit të Energjisë Elektrike
<b>UNMIK</b>	United Nations Mission in Kosovo/Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
<b>ZRrE</b>	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
<b>SCADA/EMS</b>	Kontrolli i sistemit dhe grumbullimi i të dhënave/Sistemi i menaxhimit të energjisë
<b>Sn</b>	Fuqia nominale
<b>DGC</b>	Data General Connection (Grumbullimi i të dhënave të përgjithshme)

# Lista e tabelave dhe grafikoneve

<b>Tabela 1.</b>	Gjatësitë e linjave transmetuese dhe kapaciteti transmetues i tyre.
<b>Tabela 2.</b>	Kapacitetet transformuese për vitin 2008
<b>Tabela 3.</b>	Funksionimi i Sistemit të transmisionit
<b>Tabela 4.</b>	Krahasimi i humbjeve për vitet 2007-2008
<b>Tabela5.</b>	Parametrat e performancës së prodhimit vendor dhe importeve dhe eksporteve të realizuara
<b>Tabela6.</b>	Faturimi i transitit sipas metodologjisë “By LowEKC” për periudhën korrik 2004 – dhjetor 2008
<b>Tabela7.</b>	Të dhënat e burimeve njerëzore të KOSTT-it për vitin 2008
<b>Tabela8.</b>	Vëllimi i trajnimeve dhe udhëtimeve zyrtare, siç janë ato për pjesëmarrje në grupe punuese të regionit të implementuara gjatë vitit 2008
<b>Tabela.9</b>	Tarifat e aprovuara për vitin 2008
<b>Fig.1.</b>	Energjia e pa furnizuar 2007
<b>Fig.2.</b>	Energjia e pa furnizuar 2008
<b>Fig.3.</b>	Shfrytëzueshmëria e rrjetit të transmisionit për vitin 2007 dhe 2008
<b>Fig.4.</b>	Diagrami i krahasimit të humbjeve në % sipas muajve për vitet 2007-2008
<b>Fig.5</b>	Krahasimi i intervenimeve 2007-2008
<b>Fig.6.</b>	Llojet e rënieve gjatë vitit 2008
<b>Fig.7.</b>	Krahasimi i rënieve gjatë vitit /2007/2008
<b>Fig.8</b>	Krahasimi i vëllimit të punës 2006-2008
<b>Fig.9.</b>	Bilanci i planifikuar dhe bilanci i realizuar 2008
<b>Fig.10</b>	Konsumi vjetor dhe piku prej vitit 1999 deri 2008
<b>Fig.11</b>	Konsumi i energjisë dhe ngarkesa maksimale për çdo muaj të vitit 2008
<b>Fig.12.</b>	Konsumi dhe reduktimet gjatë vitit 2008
<b>Fig.13.</b>	Lakorja e kohëzgjatjes së ngarkesës
<b>Fig 14.</b>	Rrjedhat e energjisë “prodhim-transmetim-distribuim-konsumatori i fundit”
<b>Fig 15.</b>	Bilanci i realizuar vjetor në transmision në formë relative

<b>Fig.16</b>	Shitjet e realizuara
<b>Fig 17</b>	Importi të dhëna krahasuese
<b>Fig.18.</b>	Mesatarja e devijimeve orë për orë për vitin 2008
<b>Fig.19.</b>	Krahasimi i jobalancave negative dhe pozitive për vitin 2008 nëpër orë
<b>Fig.20.</b>	Krahasimi i konsumit të brendshëm dhe transitit
<b>Fig.21.</b>	Të hyrat e simuluar të KOSTT-it sipas metodologjive të ndryshme.
<b>Fig.22.</b>	Projektet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2008
<b>Fig.23.</b>	Struktura organizative e funksioneve në KOSTT

# Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës





# I. KOSTT sh.a

Është Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës. KOSTT është themeluar më 1 korrik 2006, si shoqëri aksionare, si rezultat i ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë, në bazë të kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, ku Kosova është anëtare me të drejta të barabarta. Si ndërmarrje publike, KOSTT funksionon në bazë të dy licencave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) më 1 tetor 2006: Licenca për Operim të Sistemit të Transmisionit dhe Licenca për Operim të Tregut të energjisë elektrike. KOSTT është përgjegjës për planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë; sigurimin e një qasjeje të hapur dhe jodiskriminuese; funksionimin e tregut të ri të energjisë elektrike; sigurimin e kushteve të cilat nxisin konkurrencën në Kosovë; bashkëpunimin me OST-të fqinje në dobi të Kosovës dhe të rajonit.

## Gjatësia e përgjithshme e linjave në pronësi të KOSTT sh.a është -1058.22 km

- 5 linja 400kV – 181.4 km
- 15 linja 220kV – 231.82 km <sup>1</sup>
- 38 linja 110kV – 645 km

## Nënstacione

- 1 Nënstacion 400/220 kV me kapacitet të transformatorëve 1200 MVA
- 3 Nënstacione 220/110 kV me kapacitet të transformatorëve 1000 MVA
- 1 Stacion shpërndarës 220kV
- 1 Nënstacion 220/35/10 kV vetëm fushat 220kV
- 24 Nënstacion 110/(35 ose 10) kV vetëm fushat 110kV

Falë pozitës qendrore gjeografike që ka shteti ynë, sistemi i transmisionit me të cilin operon KOSTT, edhe pse

i vogël, paraqet një nyje me shumë interes, gjë që dëshmohet me interkoneksione të fuqishme si në vazhdim

- 1 linjë 400 kV me Serbinë
- 1 linjë 400 kV me Malin e Zi
- 1 linjë 400 kV me Maqedoninë
- 1 linjë 220 kV me Serbinë
- 1 linjë 220 kV me Shqipërinë
- 2 linja 110 kV me Serbinë

**VIZIONI** - Të jetë kompani profitabile për transmetimin e sigurt dhe stabil të energjisë elektrike, e përgjegjeshme ndaj shoqërisë dhe mjedisit, e integruar në mekanizmat evropian.

## MISIONI - Të sigurojë:

- shërbime cilësore, duke implementuar të arritura tekniko-teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit;
- transparencë dhe jodiskriminim në tregun konkurrues të energjisë elektrike;
- avancim të pozitës në nivelin rajonal dhe evropian, përkrahur nga ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve njerëzore.

<sup>1</sup> Linjat e dëmtuara të cilat janë jashtë funksionit L212 dhe L215 (NS Kosova A-NS Shkupi) nuk janë kalkuluar në gjatësinë totale.



## Fjala e Drejtorit Menaxhues të KOSTT sh.a

17 shkurt 2008 – Kosova shtet i pavarur dhe sovran – kthesa historike për Kosovën dhe ngjarja kryesore në fillimviti 2008 edhe për KOSTT, që përcillet me një rekord ngarkese prej 967MW, që është më e larta në historinë e SEE të Kosovës në një rën anë dhe në anën tjetër, para nesh, shtrohen sfida dhe detyra të reja si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Programi investiv për rritjen e kapaciteteve të transmissioinit dhe ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit të transmissioinit ka karakterizuar vitin 2008. Gjatë këtij viti janë përfunduar projekte të një rëndësie të veçantë për sistemin tonë, dhe ka filluar implementimi i projekteve të reja me të cilat dukshëm do të përmirësohet kualiteti i shërbimeve të KOSTT dhe zvogëlimi i fyteve të ngushta. Këto përmirësime pritet që të jenë të ndjeshme sidomos në dimrin e vitit 2009/2010.

Në lidhje me këtë mbështetje të çmuar kanë dhënë Buxheti i Kosovës dhe donatorët, si Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

**Kalimi nga faza e mirëmbajtjes emergjente të sistemit në atë preventive, që vërehet në ngritjen e gatishmërisë së rrjetit të transmissioinit, përkatësisht zvogëlimin e prishjeve për 31.77% në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 janë rezultat i drejtpërdrejtë i përkushtimit dhe profesionalizmit të stafit menaxherial, inxhinjerik dhe teknik.** Krijimi i bazës së të dhënave të sistemit, implementimi i të arriturave tekniko-teknologjike dhe trajnimi i vazhdueshëm në këtë sektor janë garancë për ngritjen e mëtejme të sigurisë dhe stabilitetit të sistemit të transmissioinit.

Operimi i sistemit gjatë vitit 2008 nga dispeçerët e Qendrës Nacionale Dispeçerike të Republikës së Kosovës ka shënuar progres të theksuar, falë profesionalizmit dhe përkushtimit të stafit, si dhe trajnimeve dhe procedurave bashkëkohore të adoptuara për operim efikas.

Sikurse edhe në vitet 2006 dhe 2007 (pra që nga themelimi i KOSTT), edhe në vitin 2008 raporti i auditorit të pavarur është pa kualifikime, që tregon profesionalizmin dhe përkushtimin e punëtorëve të KOSTT në respektimin e përpiktë të legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi.

**Tradita e mirë vazhdon edhe në fushën e sigurisë në punë, përmbushet plotësisht objektivi - zero aksidente në punë, me gjithë vëllimin shumë të theksuar të projekteve dhe intervenimeve në sistemin e transmissioinit.**

KOSTT gjatë vitit 2008 ka bërë harmonizimin e të gjitha akteve nënligjore dhe dokumenteve përcjellëse në pajtim me Ligjin për Ndërmarrje Publike. Poashtu, kujdes i posaçëm i është kushtuar përmbushjes së obligimeve që dalin nga Licencat e OST-së dhe OT-së, si dhe implementimit të provizioneve që dalin nga dokumentet relevante të aprovuara nga ZRRrE-ja.

Progresi i arritur me përkrahjen e Qeverisë, Zyrës së Rregullatorit dhe palëve të tjera të interesuara gjatë vitit 2008, padyshim se do të rezultojë me arritjen e caqeve të projektuara edhe në vitin para nesh.

**Në aspektin rajonal KOSTT ka arritur një progres në procesin e përfshirjes në mekanizmat dhe asociacionet rajonale dhe ndërkombëtare, siç është përfshirja e KOSTTt në “Regjionin e 8” dhe nën-**

shkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për themelimin e Zyrës për Koordinimin e Ankandëve (Coordinated Auction Office), që ka të bëjë me alokimin e kapaciteteve të transmisionit në Evropën Juglindore. Përkundër angazhimit maksimal vazhdojmë të përballemi me probleme lidhur me pjesëmarrjen e plotë në organizmat dhe mekanizmat rajonale. Zgjidhja adekuate kërkon angazhim dhe përkrahje të nivelit më të lartë politik vendor dhe ndërkombëtar. KOSTT gjatë vitit 2008 ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për ngritjen e problemit në të dy rrafshet, si atë ndërkombëtar po ashtu edhe atë vendor (Ankesa në Komunitetin e Energjisë në Vjenë, takime të nivelit më të lartë në KE - DG TREN, ETSO, involvimi i resorseve kompetente të Qeverisë së Republikës së Kosovës – MEM, MEF si dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë të EULEX – ICO, ECLO; prezantimi përmes intervistave dhe shkrimeve në media elektronike dhe të shkruara brenda dhe jashtë vendit, potencimi i problemit në konferenca dhe takime rajonale etj.)

**Gjatë vitit 2008 është arritur progres sinjifikant në lidhje me Projektin e linjës 400kV Kosovë – Shqipëri, që pritet të konkretizohet me fillimin e punëve gjatë vitit 2009. Po ashtu është përfunduar**

**përgatitja e marrëveshjeve interkonektive me sistemet fqinje dhe në këtë drejtim janë bërë bisedat preliminare me OST – Shqipëri dhe Malin e Zi.**

Të gjitha sukseset e KOSTT u atribuohen punëtorëve të kualifikuar dhe të dedikuar zhvillimit dhe mirëqenies të së cilëve iu është kushtuar vëmendje e posaçme. Ngritja profesionale e stafit ka vazhduar edhe gjatë vitit 2008, dhe që pasqyrohet edhe me të arriturat e lartpërmendura.

Dhe në fund dëshiroj të rikonfirmoj përkushtimin, gatishmërinë dhe angazhimin tim dhe të punëtorëve të KOSTT për zhvillimin dhe avancimin e sistemit të transmisionit në drejtim të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare të operimit të sistemeve elektroenergjetike.

*Ju falemnderit,*



**Fadil Ismajli**  
Drejtor Menaxhues, KOSTT



## Fjala e Zëvendës Drejtorit Menaxhues për Zhvillim

Koncepti i zhvillimit të KOSTT i referohet një kompleksiteti që në krahasim me simotrat e saja është shumë më vëllimor, dhe që duhet të realizohet për një periudhë më të shkurtër kohore. Prandaj, gjatë vitit 2008 është bërë rishikimi i parametereve real të Planit Afatmesëm të Biznesit (PAB), duke vendosur edhe një mekanizëm të implementimit aktiv të objektivave të këtij plani.

Azhurnimet në PAB i referohen parametereve kryesore që kanë ndikim në përmirësimin e afarizmit, si: strategjisë së buxhetimit të mirëmbajtjes; zvogëlimi i humbjeve të energjisë elektrike; plani i zhvillimit afatmesëm të sistemit të transmisionit; strategjia rreth arritjes së objektivave të zhvillimit të tregut të energjisë elektrike dhe strategjisë së zhvillimit të kapaciteteve të resurseve humane, që të mund të përballen me sfidat aktuale dhe të së ardhmes. Janë identifikuar edhe instrumentet dhe mekanizmat e implementimit të objektivave të rishikuara, duke përfshirë edhe mekanizmin e performancës individuale dhe kolektive. Synimi kryesor të cilit i referohen dokumentet planifikuese, si dhe instrumenteve për implementimin e objektivave, është që në një periudhë 3 deri 5 vjeçare KOSTT nga një kompani që subvencionohet për zhvillimin e vet, gradulisht të shndërrohet në një kompani financiarisht të vetqëndrueshme me parametra që mundësojnë qasjen në institucionet ndërkombëtare të financimit. Arritja e këtij synimi ka një rëndësi jetike për KOSTT, meqenëse edhe pas kësaj periudhe buxhetet për zhvillim do të vazhdojnë të jenë të rendit €40 Mil në vit. Si përfundim, të arritura e deritashme reflektojnë se KOSTT ka përkushtimin dhe vullnetin, duhet të arrijë dhe do të arrijë objektivat zhvillimore të cilat do ta rendisin në një kompani me performanca që do të çmohen.

**Naim Bejtullahu,**  
*Zëvendësdrejtor menaxhues për zhvillim*



## Fjala e Zëvendës Drejtorit Menaxhues për Operim

Operatori i Sistemit dhe Transmisionit ofron shërbime 24 orë në kohë reale për menaxhimin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës. Bazuar në parimin themelor që energjia e prodhuar duhet të jetë e barabartë me energjinë e shpenzuar, atëherë operimi i sistemit është një art në vete që kërkon njohuri dhe përkushtim në çdo moment kohor. Vendimet në operimin e Sistemit në çdo moment kohor kanë ndikim të madh teknik, financiar, njerëzor etj.

Operimi i sistemit elektroenergjetik të Kosovës është i bazuar në procedurat që rrjedhin nga obligimet e Kodit të Rrjetit, Standardeve të Operimit, Doracakut të Operimit të Sistemit nga UCTE dhe standardeve tjera ndërkombëtare. Viti 2008 është karakterizuar si vazhdim i zhvillimeve me intensitet të lartë në drejtëm të rritjes së kapacitetit të rrjetës së transmisionit, me qëllim që zhvillimi i infrastrukturës t'i paraprijë rritjes së konsumit. Karshi një intensiteti të tillë të zhvillimit paraqiten sfidat e operimit të sistemit, përkatësisht për krijimin e kushteve për implementimin e projekteve dhe në të njëjtën kohë që konsumatori të mos e ndiejë mungesën e energjisë elektrike. Motoja për t'i bërë gjërat ndryshe është përcjellë edhe gjatë vitit 2008. Krijimi i Qendrës së re emergjente, rehabilitimi dhe ndërrimi i stabilimenteve ekzistuese, instalimi i shkarkuesve të mbitensionit, krijimi i infrastrukturës për monitorim të sistemit SCADA dhe telekomunikacion, testimi i funksionimit të rregullimit frekuencë -fuqi, instalimi i mbrojtjeve rele dhe miniscada dhe realizimi efikas i planit të mirëmbajtjes kanë ndikuar që sistemi të jetë më i sigurt dhe stabil gjatë vitit 2008.

Synim i KOSTT është përmbyshja e standardeve teknike evropiane të operimit, përkatësisht kriterit N-1 ( rezervës së kapaciteteve transmetuese), me përmbyshjen e të cilit KOSTT do të jetë në hap me OST-në evropiane. Prandaj, ne mbesim të përkushtuar në avancimin e këtyre standardeve dhe praktikave më të mira teknike

**Kadri Kadriu . Mr. Inxh i dipl i el.**  
*Zëvendës drejtor Menaxhues për Operim të Sistemit*

# Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2008

Bordi i Drejtorëve të KOSTT, gjatë vitit 2008, ka vepruar në përbërje të njëjtë nga viti paraparak deri në muajin qershor 2008, kur edhe ka hyrë në fuqi Ligji i ri mbi ndërmarrjet publike.

Bordi i Drejtorëve të KOSTT gjatë periudhës janar-qershor 2008 ka qenë në përbërjen vijuese:

1.	<b>Gazmend Daci</b>	<b>Kryesues</b>
2.	<b>Fadil Ismajli</b>	<b>Drejtor Menaxhues, Anëtar me automatizëm</b>
3.	<b>Bashkim Krasniqi</b>	<b>Anëtar</b>
4.	<b>Ilir Aliu</b>	<b>Anëtar</b>
5.	<b>Bujar Pallaska</b>	<b>Anëtar</b>

Bordit në cilësinë e sekretarit i ka shërbyer Kimete Fazliu, juriste. Gjatë kësaj periudhe, Bordi i Drejtorëve ka zhvilluar aktivitetet e veta, duke dhënë kontributin e vet maksimal në kryerjen e detyrave konkrete për zhvillimin e kompanisë.

## Anëtarët e Bordit të Drejtorëve 2006-2008 japin shkurt vlerësimet e tyre për KOSTT

*“Është vërtet kënaqësi e veçantë, por edhe e vështirë të përmbledhësh në tri fjali gjithë atë veprimtari dhe punë të konsiderueshme të bëra në KOSTT që nga themelimi i saj dhe më vonë në konsolidimin e saj si një kompani lider dhe referuese për sektorin elektroenergetik të Kosovës”.*

*Dr. Gazmend Daci*

*“Ishte kënaqësi e veçantë për mua që pata rastin të isha në procesin e Konstituimit dhe mbarëvajtjes së punëve të Kompanisë më të suksesshme të periudhës së fundit në Kosovë”.*

*Bashkim Krasniqi*

*“Puna e KOSTT sh.a, gjatë Bordit të vitit 2008, nuk kishte me qenë e kryer në nivelin që është pa kontributin dhe profesionalizmin e Kryetarit të Bordit dhe Drejtorit menaxhues”.*

*Bujar Pallaska*

*“Si Drejtor i Bordit, gjatë viteve 2006-2008, isha i impresionuar nga punëtorët e KOSTT të cilët jo vetëm që mund t'i ekzekutonin detyrat, por gjithashtu ishin të gatshëm që të ndërhyjnë dhe të ndihmojnë njëri tjetrin sipas nevojës. Kjo rrjedh nga qasja pozitive dhe puna ekipore, udhëbequr nga një menaxhment i cili është i ngritur profesionalisht”.*

*Ilir Aliu*

# KOSTT në numra

Numrat të cilët e karakterizojnë në përgjithësi veprimtarinë e kompanisë

1	Qendër Nationale Dispeçerike
1	Linja interkonektive 220 kV me Shqipërinë
1	Linja interkonektive 400 kV me Maqedoninë
1	Linja interkonektive 400 kV me Malin e Zi
4	Linja interkonektive (1-400 kV, 1-220 kV dhe 2-110 kV) me Serbinë
3	Nivele të tensioneve me të cilat operon KOSTT sh.a ( niveli 400, 220 dhe 110 kV)
3.49	km linja më e shkurtër 110 kV që lidh NS “Kosova A” me NS Bardhi
7	Linja interkonektive me shtetet fqinje
10	Transformatorë në pronësi të KOSTT
20.9	% e punëtorëve janë të gjinisë femërore
29	Nënstacione
31.77	% janë zvogëluar prishjet në krahasim me vitin 2007
38	% Inxhinier
43	Mosha mesatare e punëtorëve të KOSTT-
50	% e punëtorëve me përgatitje superiore profesionale
70.95	km linja më e gjatë 400 kV Kosovë-Serbi (pjesa e linjës brenda Kosovës)
79.1	% të punëtorëve janë të gjinisë mashkullore
181.4	km gjatësia e linjave 400 kV
201	Punëtorë
231.82	km gjatësia e linjave 220 kV
645	km gjatësia e linjave 110 kV
930	MW kapacitetet bartëse të KOSTT
967	MW transmetimi rekord i energjisë i realizuar me 17 shkurt 2008
1058.22	km gjatësia e përgjithshme e linjave
3000	MVA kapacitete transformuese
8562.544	GWh energji ka hyrë në rrjetin e transmisionit gjatë vitit 2008
26 000 000	€-vlera e projekteve investuese të realizuara gjatë vitit 2008
219.363.000	€-vlera e planifikuar e investimeve sipas PZhST 2009-2013

# Qeverisja Korporative dhe Korniza rregullative e re nën të cilën vepron KOSTT

**KOSTT sh.a është themeluar si kompani e mëvetëshme nga ndërmarrja vertikalisht e integruar duke i'u nënshtruar procesit të korporatizimit. Krijimit të KOSTT i ka paraprirë vendimi i Qeverisë së Kosovës në korrik të vitit 2005 për ristrukturimin e Korporatës Energjetike të Kosovës-KEK. Si rrjedhojë nga 1 korriku i vitit 2006 funksioni i transmisionit dhe dispeçingut janë ndarë zyrtarisht nga KEK-u dhe menaxhohen nga KOSTT.**

Fillimisht, KOSTT ka qenë i menaxhuar nga Bordi i Drejtorëve nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, bazuar në legjislacionin e atëhershëm në fuqi. Ligji i ri për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 ka ndryshuar strukturën korporative të KOSTT dhe ndërmarrjeve të tjera publike. Sipas ligjit në fjalë, Njësia e Politikave dhe Monitorimit të NP e cila është themeluar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave është ku-jdestar i të gjitha çertifikatave fizike, të cilat i përfaqësojnë aksionet në KOSTT, dhe që janë në pronësi të

Republikës së Kosovës.

Ligji i ri nuk ka ndryshuar strukturën e menaxhmentit të KOSTT, i cili sërish udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues (Kryeshefi Ekzekutiv), që janë kompetentë për implementimin e politikës dhe strategjisë së Aksionarëve. Ligji ka përforcuar rolin e Komisionit të Auditimit dhe strukturën raportuese më të shpeshtë ndaj Aksionarëve (Planet e biznesit vjetor dhe raportet vjetore dhe tremujore). KOSTT sh.a funksionon në bazë të akteve nënligjore, si Statuti, Akti i themelimit, Kodi i Sjelljes dhe Etikës, si dhe akteve të tjera që nxirren bazuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Ligji i Ndërmarrjeve Publike nuk ka eliminuar nevojën që KOSTT edhe më tutje të veprojë bazuar në ligjet bazë të energjisë dhe legjislacionit sekondar relevant.

KOSTT i ka ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për raportim të rregullt dhe kohor dhe implementimin e plotë të dispozitave të ligjeve në fuqi.

## Objektivat e kompanisë për vitin 2008

1. Të sigurojë qëndrueshmëri financiare
2. Të krijojë një organizatë efektive dhe efiçente dhe të arrijë përmirësime të vazhdueshme në produktivitet
3. Të mirëmbajë dhe avancojë funksionin e operimit të sistemit
4. Të avancojë kapacitetet e planifikimit dhe zhvillimit të sistemit
5. Të përmirësojë performancat e sistemit të transmisionit
6. Të sigurojë ndërtimin efektiv të rrjetit të transmisionit
7. Të krijojë mundësitë për operim të tregut në përputhje me zhvillimet e pritura të tregut të energjisë elektrike.
8. Të përmbushë obligimet nga Traktati duke marrë pjesë aktive në zhvillimin dhe operimin e tregut regional (përfitoj/ kontribuoj nga zhvillimi regional i tregut)
9. Të ndërtojë marrëdhënie efektive me palët e interesit
10. Të sigurojë që KOSTT është punëdhënës i mirë dhe atraktiv
11. Siguron që KOSTT është një organizatë përgjegjëse ndaj shoqërisë dhe është përgjegjëse nga aspekti mjedisor
12. Të krijojë një ambient të sigurt pune

*Të dhënat e prezantuar më poshtë në kuadër të Raportit Vjetor pasqyrojnë punën e KOSTT sh.a në përmbushjen e objektivave*



## II. Operimi i Sistemit të Transmisionit



# Rëndësia dhe pozita e sistemit të transmisionit të Kosovës

Pozita qendrore gjeografike dhe ndërlidhja e fuqishme e rrjetit të transmisionit të vendit tonë, me rrjetet përreth, e renditë Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës në njërin nga nyjat më të rëndësishme elektroenergjetike në regjion. KOSTT sh.a operon me tri nivelet e tensioneve, 400kV, 220kV dhe 110kV. Rrjeti i Transmisionit të Republikës së Kosovës karakterizohet me rrjetë të fuqishme të interkonjeksionit të tensionit 400kV, i ndërlidhur fuqishëm në rrjetin regional. Aktualisht, përmes rrjetit horizontal tranzitohet për nevojat e vendeve eksportuese (veri-lindje) dhe importuese (jug) të regjionit

sasia vjetore tejet e madhe e energjisë elektrike e cila sillet rreth 62% të konsumit vjetor të Kosovës. Gjithashtu burimet e fuqishme të gjenerimit të energjisë elektrike në nyjën e Kosovës në një pikë optimale të shpërndarjes së gjeneratorëve të tërë regjionit e bëjnë të rëndësishme nga këndvështrimi i operimit të sistemit transmetues regjional me parametra kualitativ të një kostoje më të ulët.

Kosova si zonë elektroenergjetike është e ndërlidhur përmes linjave ndërkufitare me katër shtetet fqinje: Serbi, Maqedoni, Mali i Zi dhe Shqipëri.

## Kapacitetet e rrjetit të transmisionit

Linjat e tensionit të lartë 400, 220 dhe 110kV menaxhohen nga KOSTT. Në tabelën 1 mund të shihen gjatësitë dhe kapacitetet transmetuese për gjatësi të linjave

ekzistuese të rrjetit të transmisionit të Kosovës bazuar në gjendjen e fundit të vitit 2008.

Linjat Ajrore 2008	Gjatësia totale në Kosovë [km]	Kapaciteti transmetues $C_t = S_n * L$ [MVA km]
400kV	181.4	238 846
220kV	231.82	77 506
110kV	645	65 845

Tabela 1. Gjatësitë e linjave transmetuese dhe kapaciteti transmetues i tyre.

Ndërsa kapacitetet aktuale transformuese të rrjetit të Transmisionit të cilat menaxhohen nga KOSTT janë të koncentruara në nënstacionet 400/220kV dhe

220/110kV. Në tabelën 2 janë paraqitur kapacitetet transformuese për vitin 2008.

Autotransformator	Numri i Autotransformatorve	Kapaciteti total transformues (MVA)
400/220kV NS Kosova B	3	3x400=1200MVA
220/110kV NS Kosova A	2	6x150=900MVA
NS Prishtina 4	2	2x150=300MVA
NS Prizreni 2	2	2x150=300MVA

Tabela 2. Kapacitetet transformuese për vitin 2008

Kapacitetet aktuale në transformimin 220/110kV në tabelën e mësipërme janë për 100MVA më e vogël se ajo në kapitullin e hyrjes me që në fund të vitit 2008 një njësi me fuqi prej 100MVA në nënstacionin 220/110kV “Kosova A” është dëmtuar dhe pritet zëvendësimi me një njësi të kapacitetit 150MVA.

Gjithashtu një pjesë e ngarkesës mbulohet nga transformimi 220/35kV nënstacion nën pronësinë e industrisë shkrirëse të “Ferronikelit” me fuqi 2x160MVA dhe transformimi 220/35+10kV të fuqisë 2x40MVA në pronësi të përbashkët me KEK - Shpërndarjen.

# Funksionimi i sistemit të transmisionit gjatë vitit 2008

Në vitin 2008 në përgjithësi është shënuar një performancë e mirë e funksionimit të sistemit të transmisionit të menaxhuar nga KOSTT. Shfrytëzueshmëria e rrjetit ka qenë për 0,022 % më e madhe gjatë vitit 2008, ndërkaj energjia e pafurnizuar gjatë vitit 2008 ka qenë më e vogël se sa në 2007 për 304 MWh ose për 2,65 %, tabela 3.

KOSTT ka dëshmuar një përkushtim të vazhdueshëm në operimin e sistemit elektroenergetik, ku me

angazhimin të shtuar, Qendra Nacionale Dispečerike ka arritur që të menaxhojë transmisionin rekord të energjisë. Derisa në vitin 2006 piku i energjisë së transmetuar ka qenë 916 MW; në vitin 2007-933 MW, ndërkaj rekordi më lartë i transmetimit është shënuar pikërisht në Ditën e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 në ora 21:00, dhe rrjeti transmetues i Kosovës ka transmetuar 967 MW energji, që shënon rekordin e transmetimit të energjisë elektrike të arritur ndonjëherë.

2007	Gjithsejt
En. e pafurnizuar (MWh)	11 470
Konsumi (MWh)	4 678 985
En. e pafurnizuar (%)	0.245
Shfrytëzueshmëria e rrjetit të transmisionit 2007	99,755
2008	
En. E pafurnizuar(MWh)	11 166
Konsumi(MWh)	5 012 667
En. e pafurnizuar (%)	0.222
Shfrytëzueshmëria e rrjetit të transmisionit 2008	99,778
2008/2007 (%)	
En. e pafurnizuar	97,350
Konsumi	107,131
En. e pafurnizuar (%)	90.890
Shfrytëzueshmëria e rrjetit të transmisionit	100.022

Tabela 3. Funksionimi i Sistemit të transmisionit

Në grafikun në vijim janë paraqitur vlerat për secilin muaj, ku në grafik në formë shtylle është paraqitur energjia e pafurnizuar në MWh, ndërsa në formë linjore

është paraqitur përqindja e energjisë së pafurnizuar ndaj konsumit bruto të Kosovës për vitin 2007 dhe 2008.




Fig.1. Energjia e pa furnizuar 2007




Fig. 2. Energjia e pa furnizuar 2008

Në grafikun 3 është paraqitur edhe shfrytëzueshmëria e rrjetit të transmisionit për vitin 2007 dhe 2008 e cila llogaritet sipas formulës:  $Shf.rr.=100\% - E_{pf}$




Fig. 3. Shfrytëzueshmëria e rrjetit të transmisionit për vitin 2007 dhe 2008

## Matjet

Matja e rrjedhave të energjisë që kalon nëpër rrjetin e transmisionit, realizohet përmes Grupeve Matëse të instaluar nëpër secilin nënstacion ku ekzistojnë kufijtë e matjes në mes të KOSTT- dhe “të tjerëve” (TSO fqinjë, gjeneratorëve, DSO dhe konsumatorëve të kualifikuar (privilegjuar). Grupet matëse të instaluar në rrjetin e Transmisionit janë të klasifikuara në dy grupe:

- Grupet matëse të vendosura në kufi të aseteve dhe
- Grupet matëse të cilat nuk janë të vendosura në kufi të aseteve.

Ky klasifikim i matjeve do të eliminohet në vitin 2009 kur në KOSTT pritet të përfundojë projekti tejet i rëndësishëm “ITSMO Njehsorët”, projekt ky që parasheh instalimin e grupeve të reja matëse (ku përfshihen transformatorët matës, njehsorët, aplikacioni për grumbullimin e të dhënave në qendër, etj.) në të gjitha pikat matëse të rrjetit të transmisionit në nivelin 110kV. Pas implementimit të këtij projekti, sistemi i matjeve në KOSTT, në pjesën më të madhe, do të jetë sistem plotësisht në pajtueshmëri me Kodin e Matjeve dhe i krahasueshëm me sistemet moderne të matjeve.

Mbarëvajtja e matjeve në linjat e interkoneksionit në mënyrë të vazhdueshme realizohet me bashkëpunime ra-

jonale dhe KOSTT në periudha të rregullta kohore është në kontakt me palët homologe nga OST- Shqipëri, MEPSO – Maqedoni, si dhe me EPCG – Mali i Zi, me të cilët të paktën një herë në muaj mban kontakte të rregullta me qëllim të këmbimit të të dhënave matëse të energjisë elektrike e cila rrjedh gjatë muajve përkatës nëpër këto linja.

## Humbjet

Një performancë tjetër e suksesshme nga aspekti i matjeve ka qenë edhe qasja ndaj nivelit të humbjeve në transmision ku, duke parë se niveli i humbjeve ishte jo i dëshirueshëm, janë marrë aksione të ndryshme për zvogëlimin e tyre, duke filluar me caktimin e koeficienteve për pikat matëse, të cilat nuk janë të vendosura në kufi, vulosja (plombimi) i qarqeve matëse në pothuaj të gjitha pikat matëse, kontrollimi periodik i rregullt dhe kontrollimi i shtuar i pikave matëse, analiza e rrjedhave të energjisë, ndërrimi i transformatorëve matës me saktësi të dyshimtë me transformatorë të rinj etj.

Rezultatet e arritura janë paraqitur në diagramin e mëposhtëm ku është paraqitur krahasimi i humbjeve për vitet 2007 dhe 2008 në baza mujore/vjetore në formë tabelare dhe grafike

Periudha Janar-Dhjetor		Prodhimi	Importi	Exporti	Konsumi	Energjia në Disponim	Energjia e Realizuar	Humbjet në transmision	Vlera e Humb.
		GWh	GWh	GWh	GWh	GWh	GWh	GWh	%
		a	b	c	d	e=a+b	f=c+d	g=e-f	h=g/e
Total	2007*	4411,306	3826,299	3545,591	4431,061	8237,605	7976,652	260,953	3.17%
	2008**	4595,872	3966,666	3549,876	4802,159	8562,539	8352,035	210,503	2.46%
	Diferenca%	4.02%	3.54%	0.12%	7.73%	3.79%	4.49%	-23.97%	-0.71%

\* Humbjet e barazuara në kufi me koeficienta sipas DGC2000

\*\*Humbjet e barazuara në kufi me koeficienta sipas gjatësisë së linjave

Tabela 4. Krahasimi i humbjeve për vitet 2007-2008




Fig.4. Diagrami i krahasimit të humbjeve në % sipas muajve për vitet 2007-2008

Vlerat më të ulëta gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2007 në krahasim me vitin 2008 kryesisht u referohen korrigjimeve të gabimeve të matjeve të identifikuar në këtë periudhë për periudhën e kaluar.

## Mirëmbajtja

KOSTT në bazë të licencës për Operim të Sistemit është përgjegjës për mirëmbajtjen e rrjetit të transmisionit. Sistemi i Transmisionit përfshin të gjitha linjat në nivelin e tensionit 400kV, 220, dhe 110kV, si dhe të gjitha nënstationet në nivelin e tensionit 400/220kV, 400/110kV, dhe 220/110 kV/kV, si dhe stabilimentet e tensionit të lartë 110kV në nënstationet 110/x kV.

Të gjitha këto asete përbëjnë një tërësi funksionale dhe komplekse që mundësojnë funksionimin e sistemit transmetues të Kosovës.

Funksionimi efikas i sistemit arrihet me ndihmën e investimeve operative të cilat realizohen në bazë të planit operativ të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Plani operativ i mbështetur me buxhetin e OPEX-it ku përfshihet periudha tarifore trevjeçare ka dy objektiva kryesore:

- Realizimin e planit të mirëmbajtjes së linjave dhe pajisjeve ekzistuese nëpër nënstatione dhe të gjitha shpenzimet operative rreth tyre
- Revitalizimin e pajisjeve ekzistuese të cilat nuk janë në gjendje të mirë

Dinamika e zbatimit të planeve të mirëmbajtjes gjithnjë është e ndërlidhur me harmonizimin e planeve të mirëmbajtjes së kapaciteteve gjeneruese dhe ngarkesës të kyçura në rrjetin e transmisionit, si dhe me sistemet fqinje me të cilët jemi të lidhur në interkoneksion. Gjatë harmonizimit të planeve gjithnjë mëtohet që të minimizohen ndikimet në furnizimin e konsumatorëve. Mirëmbajtja për dallim nga revitalizimi është kryesisht e natyrës preventive.

Revitalizimi i pajisjeve ekzistuese në kuadër të OPEX-it ka dy objektiva që kanë ndikim të rëndësishëm në rrjetin e Transmisionit:

- **Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së operimit të stabilimenteve,**
- **Ngritja e kapaciteteve ekzistuese të Transmisionit aty ku kjo paraqitet si mundësi.**

Në kuadër të këtij buxheti janë zhvilluar këto projekte:

- **Ndërrimi i përcuesve të linjave 110kV dhe përforsimi i shtyllave ekzistuese me gjatësi L=20.2km;**
- **Ndërrimi i fushave të stabilimenteve 220kV, 3 fusha komplet;**
- **Ndërrimi i ndërprerësve 110kV, 6 copë;**
- **Ndërrimi i transformatorëve matës rrymorë 110kV, 220kV, 400kV , 45 copë;**
- **Ndërrimi i transformatorëve matës të tensionit 110kV , 16 copë;**
- **Ndërrimi i shkarkuesve të mbitensionit, 110kV, 220kV, =200 copë;**
- **Ndërrimi i mbrojtjeve rele, 110kV, = 9 copë;**

Ndikimi i rehabilitimit të rrjetës transmetuese ka rezultuar me rritjen e kapacitetit transmetues të rrjetës 110kV për 85 MW. Ndërsa investimet në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit kanë rezultuar me zvogëlimin e prishjeve në sistem, furnizimin më të sigurt të konsumit, zvogëlimin e energjisë së padërguar tek konsumatori për shkak të transmisionit. Në vijim është paraqitur krahasimi i intervenimeve 2007-2008 dhe operimet gjatë vitit 2008.




Fig.5 Krahasimi i intervenimeve 2007-2008




Fig.6. Llojet e rënieve gjatë vitit 2008




Fig.7. Krahasimi i rënieve gjatë vitit /2007/2008

Diagrami në fig.7 tregon se në periudhën e dytë të vitit ka një përmirësim të theksueshëm të rënieve, i cili ndërlidhet me shtimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes dhe revitalizimit të sistemit. Një mirëmbajtje e intensifikuar, e cila ka filluar të japë efektet, mund të vërehet nga krahasimi i aktiviteteve të mirëmbajtjes sipas urdhërësave të punës gjatë tri viteve të fundit, siç mund të shihet në figurën e mëposhtme




Fig.8 Krahasimi i vëllimit të punës 2006-2008

# Telekomunikimi në Sistemin e Transmisionit

Gjatë vitit 2008 KOSTT i ka kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit të infrastrukturës telekomunikuese, duke pasur parasysh se sistemet e transmetimit të energjisë elektrike kërkojnë rrugë transmetuese komunikuese të sigurisë së lartë, për qarkullimin e të dhënave dhe komunikimeve midis objekteve elektroenergjetike dhe qendrave kontrolluese (kryesore dhe emergjente), për sistemet dhe funksionet në vijim:

- SCADA/EMS që lidhet me kontrollin e rrjetit transmetues elektroenergjetik, përfshirë këtu kontrollin e nënstacioneve
- Matjet e tensionit të lartë (HVM)
- Komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave në distancë dhe vlerave të matura me qendrat nacionale kontrolluese të vendeve fqinje

Me qëllim të ngritjes së sigurisë dhe zhvillimit të sistemit telekomunikues në KOSTT në fund të vitit 2008 janë kontraktuar pajisjet dhe rrugët e reja telekomunikuese:

1. Për shfrytëzimin e kanaleve kablloviqe të Rrjetit të Distribucionit nga NS 35/10 Prishtina 3 – NS 110/10 NS Prishtina 2, për shtrirjen e kabllit fiber-optik. Ndërsa drejtimi NS 110/10 Prishtina 2 – NS 220/110 kV Prishtina 4 do të realizohet me implementimin e kabllit OPGW.

2. Me projektin e SCADA/EMS dhe Telekomunikacioni parashihet ndërrimi i përçuesve mbrojtës me kabllo të tipit OPGW (Optical Ground Wire). Qëllimi është të sigurohet një rrjet SDH shtyllë ('backbone network'), duke shfrytëzuar fijet optike si medium transmetues.

## Sistemi SCADA / RTU

Funksioni themelor i sistemit SCADA/RTU është monitorimi, komandimi dhe grumbullimi i të dhënave në kohë reale nga të gjitha nënstacionet e menaxhuara nga KOSTT dhe atyre në kufirin KOSTT-KEK (100/X kV, 220/X kV). Sistemet SCADA të cilat aktualisht disponon KOSTT janë të vendosura në nënstacionet në pronësi të KOSTT dhe në disa NS 110/x kV (Peja 2, Prishtina 5) në NS 220/x kV (NS Podujeva). Këto sistemeshërbejnë

për monitorim, komandimin e pajisjeve në këto nënstacione, si dhe për grumbullimin e të dhënave në kohë reale. Të gjitha këto SCADA sisteme, përveç NS "Kosova B", janë të prodhuesit SIEMENS dhe janë të digjitalizuara dhe të kompjuterizuara.

Në Qendrën Dispeçerike në KOSTT ekzistojnë dy HMI (Human Machine Interface) të SCADA sistemeve, të cilat kryesisht shërbejnë për grumbullimin e matjeve indikative dhe shërbejnë për përcjelljen e prodhimit dhe konsumit përmes njësisë generuese, linjave interkonektive dhe konsumit në tërësi. Pra detyra themelore e tyre është përcjellja dhe zvogëlimi i devijimit në sistemin elektroenergjetik të Kosovës menaxhuar nga KOSTT. Këto dy HMI gjithashtu janë të prodhuesit SIEMENS.

KOSTT në bashkëpunim me konsulentë të ndryshëm ka kryer studime relevante dhe ka përgatitur specifikacionin teknik për projektin SCADA/EMS dhe kontrata për implementimin e projektit është nënshkruar në dhjetor të vitit 2008.

Në vitin 2008, me anë të softuerëve ekzistues dhe pajisjeve harduerike rezervë nga SCADA sistemet e nënstacioneve, Qendra Emergjente Dispeçerike është pajisur me funksione identike të Qendrës Dispeçerike me është rritur besueshmëria e monitorimit të sistemit në shkallen ekzistuese.

Përmes projektit SCADA/EMS dhe Telekomunikacioni, KOSTT do të pajiset me sistemin më të avancuar SCADA/EMS në Ballkan, dhe me funksionet e tij do t'i përmbushë të gjitha kërkesat relevante teknike të parashtruara nga organizatat rajonale si UCTE, ETSO etj.

## Mbrojtja dhe siguria në punë

KOSTT i kushton rëndësi të madhe mbrojtjes dhe sigurisë së punëtorëve, me theks të veçantë punës në terren. Punëtorët që punojnë në terren gëzojnë sigurim shëndetësorë, ndërkaq, gjatë vitit 2008, nuk është shënuar asnjë lëndim i rëndë në vend të punës. Në bazë të Rregullores së brendshme në fuqi, punëtorët janë të pajisur me mjete mbrojtëse për punë. Gjatë vitit 2008, është organizuar trajnimi i punëtorëve të kompanisë për mbrojtje kundër zjarrit, si dhe mbrojtje në punë. Gjatë këtij viti, theks i është vënë mbrojtjes nga zjarri, me përf forcime në vendet më të ndjeshme, si dhe me instalimin e sistemit lajmërues kundër zjarrit.





## Mbrojtja e ambientit

KOSTT sh.a është i përkushtuar në minimizimin e ndikimit të pajisjeve dhe linjave në ndotjen e ambientit, edhe pse aktivitetet e KOSTT nuk konsiderohen si ndotës të mëdhenj, por më shumë ndikojnë në ndryshimet vizuale të ambientit. Në kuadër të kësaj, në implementimin e të gjitha projekteve të reja KOSTT i kushton rëndësi vlerësimit të ndikimit të pajisjeve në ambient. Në vitin 2008, KOSTT ka filluar me vendosjen e Politikës mjedisore në kompani dhe është e përkushtuar në menaxhimin e mjedisit sipas standardit ISO 14001.



## III. Menaxhimi i energjisë elektrike gjatë vitit 2008

Furnizimi i konsumatorëve me energji elektrike ka vazhduar të implementohet me një bilanc të reduktuar. Në vazhdim janë paraqitur parametrat e performancës së prodhimit vendor, importeve dhe eksporteve të realizuara.

Muajt	Janar - Dhjetor 2008		
(MWh)	E planifikuar	E realizuar	real/plan. %
TC Kosova A	1 214 316	1 239 042	102.04
TC Kosova B	3 208 320	3 302 388	102.93
Sh.A.Kosova Thengjilli	0	0	
HC Ujmani	76 000	54 442	71.63
HC Distributive	26 804	21 652	80.78
<b>Total Prodhimi</b>	<b>4 498 636</b>	<b>4 595 872</b>	<b>102.16</b>
Devijimi		- 7 264	
Eksporti		295 696	
Importi	478 600	708 195	147.97
<b>Energjia në disponim</b>	<b>4 977 236</b>	<b>5 015 635</b>	<b>100.77</b>
Distribucioni	3 855 998	4 124 724	106.97
Ferronikeli	663 500	395 485	59.61
Trepça	86 300	20 794	24.10
Sharri	60 000	62 570	104.28
Mihjet,Kos.thengj.,NS Palaj,gjenerim konsum.e jasht.KEK, LP 290	105 300	198 586	188.59
<b>Kërkesa neto</b>	<b>4 771 098</b>	<b>4 802 159</b>	<b>100.65</b>
Humbjet në bartje	205 398	210 507	102.49
<b>Kërkesa gjithsej</b>	<b>4 976 496</b>	<b>5 012 666</b>	<b>100.73</b>
Ngarkesa maksimale MW	880	967	109.89

Tabela5.Parametrat e performancës së prodhimit vendor, importeve dhe eksporteve të realizuara

Në tabelë janë paraqitur vlerat sipas Bilancit (Ribilancit) Elektroenergetik të planifikuar dhe të realizuar. Prodhimi është rritur për 2,16%, ndërsa importi me 47,97% në krahasim me atë të planifikuar, konsumi është rritur rreth për 0,7 % në krahasim me atë të planifikuar, humbjet në transmission janë rritur për 2,4% me ato të planifikuara, si dhe ngarkesa maksimale për rreth 9%. Mund të konkludohet se edhe furnizimi i konsumatorëve përveç atyre të kyçur në rrjetin e transmissionit, në përgjithësi ka pasur një rritje prej 7%. Vlera me shenjë negative në kolonën e katërt e emërtuar si devijim paraqet vlerën e energjisë së tërhequr nga sistemet e tjera e cila me përmbylljen e vitit ka mbetur të kthehet gjatë vitit 2009.




Fig.9. Bilanci i planifikuar dhe bilanci i realizuar 2008

# Konsumi



Fig.10 Konsumi vjetor dhe pikë prej vitit 1999 deri 2008

Në Fig.10 është paraqitur konsumi vjetor (GWh) prej vitit 1999 deri 2008 (i paraqitur në shtyllë), ndërsa në formë linjore janë paraqitur ngarkesat maksimale vjetore në (MW). Si mund të shihet konsumi i vitit 2008 krahasuar me atë 1999 është rritur rreth 44%, ndërsa ngarkesa maksimale është rritur për rreth 39%.




Fig.11 Konsumi i energjisë dhe ngarkesa maksimale për çdo muaj të vitit 2008

Në Fig.11. është paraqitur konsumi mujor (në formë shtyllë) i shprehur në MWh, ndërsa të shprehura në linjë janë dhënë ngarkesat maksimale mujore (MW).




Fig.12. Konsumi dhe reduktimet gjatë vitit 2008

Në Fig. 12. është paraqitur konsumi dhe reduktimet për secilin muaj të vitit 2008.




Fig.13. Lakorja e kohëzgjatjes së ngarkesës

Në Fig.13. është paraqitur lakorja e kohëzgjatjes së ngarkesës. Në këtë lakore janë paraqitur ngarkesat orë për orë për tërë orët e vitit, duke i radhitur prej ngarkesës më të madhe (967 MW) deri te ngarkesa më e vogël. Ngarkesa maksimale 967 MW është realizuar më datën 17 shkurt 2008 në ora 21.

Figurat 11,12 dhe 13 tregojnë se ngarkesa maksimale është reduktuar për shkak të mungesës së energjisë respektivisht fuqisë së pamjaftueshme për të mbuluar “pik”-un ose mungesës së kapacitetit transmetues.

# Rrjedhat e energjisë “prodhim-transmetim-distribucion -konsumatori i fundit”




Fig 14. Rrjedhat e energjisë “prodhim-transmetim-distribucion-konsumatori i fundit”

Figura 14. paraqet rrjedhat e energjisë nga prodhimi dhe interkoneksioni nëpër rrjetin transmetues (bartës) dhe distributiv (shpërndarës), e deri te konsumatori final. Interkoneksioni është paraqitur në dy pika, si rrjedha hyrëse e dhe si rrjedha dalëse të energjisë elektrike, ku përfshihen të gjitha rrjedhat (transiti, importi dhe eksporti i Kosovës). Të gjitha rrjedhat hyrëse të energjisë janë të barabarta me shumën e rrjedhave dalëse dhe

humbjeve në transmision dhe distribucion. Energjia e dalë nga rrjeti transmetues nuk përputhet plotësisht me shumën e energjisë së pranuar nga distribucioni, konsumatorët direkt dhe rrjedhat dalëse në interkoneksion, kjo për arsye se rrjedhat hyrëse në distribucion përfshijnë edhe energjinë e prodhuar nga HC Lumbardhi, e cila derdhet direkt në rrjetin distributiv.



Figura 15 paraqet bilancin e realizuar vjetor në transmision, hyrjet dhe daljet në transmision, pa përfshirë energjinë e prodhuar nga HC Lumbardhi.

Konsumi kombtarë në këtë figurë paraqet konsumin bruto, ku përfshihen edhe humbjet në distribucion.




Fig 15. Bilanci i realizuar vjetor në transmision në formë relative



## IV. Funkcionimi i tregut të energjisë elektrike



# Energjia e shitur -tregu i realizuar

Si pjesë e obligimeve të tij Operatori i Tregut ka përfunduar procesin e barazimit për vitin 2008 dhe në Fig. 16

janë paraqitur informatat rreth transaksioneve në tregun me shumicë dhe nivelin me pakicë. Këtu janë prezantuar vlerat komerciale të importit dhe eksportit, prandaj shumatat nuk bilancohen për shkak të devijimeve reale. Faktori i realizuar i Humbjeve në Transmision (TLF) në vitin 2008 ishte 1.044.

Shitjet e realizuara	GWh	Krahاسime në %	
Prodhimi i rregulluar	4 585	86.09%	78.61%
Prodhimi i kontraktuar	33	0.62%	0.56 %
Importi	708	13.30%	12.14%
<b>Gjithsej</b>	<b>5 326</b>	<b>100.00%</b>	<b>91.32%</b>
Energjia e Reduktuar*	506	8.68%	8.68%
<b>Gjithsej kërkesa</b>	<b>5 832</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>
Tregu (Konsumi) jo Tari-	395	8.20%	7.73%
Konsumi i KEK-ut	175	3.63%	3.42%
Tregu(konsumi) Tarifor	4 253	88.17%	83.08%
<b>Gjithsej Bruto Konsumi</b>	<b>4 824</b>	<b>100.00%</b>	
Exporti	296		5.78%
<b>Gjithsej shitjet</b>	<b>5120</b>		<b>100.00%</b>
Humbjet në Transmision	210	TLF	1.044

\* Sipas vlerësimeve më të mira të KOSTT

Fig. 16 Shitjet e realizuara

Energjia e shitur në nivelin e tregut me pakicë paraqet konsumin bruto të Kosovës, pa përfshirë humbjet në transmision. Nga gjithsej bruto konsumi 88.17% është shitur në tregun tarifor, ndërsa pjesa tjetër i përket konsumit vetanak të KEK-ut dhe konsumit të konsumatorëve jo tariforë.

Sa i përket tregut me shumicë nga gjithsej energjia e shitur te furnizuesi, rreth 88% e saj është shitur me çmim të rregulluar (“Kosova A” dhe “Kosova B”) ndërsa pjesa tjetër me çmim të kontraktuar.

## -Importi dhe eksporti me koston e realizuar dhe krahasimet me tregun regjional dhe tregjet e tjera

Sikurse në vitet paraprake edhe në vitin 2008 çmimet e importit kanë vazhduar të rriten në mënyrë konstante. Nga viti 2000 kemi një rritje mesatare vjetore të çmimit të importit për afër 20%, duke arritur në mbi 100 €/MWh. Në aspektin e termave relativ, importi ka mbetur në nivel të njëjtë duke mbuluar rreth 13% të kon-

sumit të reduktuar. Çmimi i lartë i importit ka ndikuar në koston e përgjithshme të sistemit, duke e ngritur çmimin mesatar të sistemit në mbi 40 % ndaj çmimit mesatar të sistemit pa import, pa llogaritur këtu koston e energjisë së reduktuar. Në figurën 17 janë paraqitur

disa diagrame rreth ecurisë së çmimit të importit nëpër vite, krahasimit të tij me çmimet e arritura në disa tregje regjionale dhe evropiane, ndikimit të tij në çmimin mesatar të sistemit etj.




Fig 17 Importi të dbëna krahasuese

Çmimet e realizuara mujore në disa tregje rajonale dhe evropiane nuk e përmbajnë komponentin apo koston e alokimit të kapaciteteve, e cila mund të jetë e rangut deri në 10% e çmimit të energjisë. Megjithatë edhe nëse e përfshijmë këtë komponentë çmimet e importit në Kosovë mbesin më të larta për mesatarisht 20% në raport me këto çmime. Kjo njëkohësisht ndikon edhe në rritjen e çmimit mesatar të sistemit. Në figurë vërehet se në

muajt ku nuk ka pasur import të kontraktuar çmimi mesatar i sistemit është më i ulët .

Një ndër elementet i cili drejtpërdrejt ka ndikuar në rritjen e çmimit të importit është procesi plotësisht jotransparent i alokimit të kapaciteteve të disa TSO-ve regjionale, si dhe obstrukcioneve dhe pengesave të vazhdueshme të operatorit serb ndaj industrisë energjetike në Kosovë.

## Problematika e balancimit nga aspekti komercial i tregut të energjisë

Është një mekanizëm që i shërben operatorit të sistemit për eliminimin e jo balancave që paraqiten gjatë realizimit të planeve ditore të nominuara një ditë para.

Aktualisht në SEE të Kosovës nuk ekziston një mekanizëm balancues, edhe pse balancimi si detyrë e operatorit të sistemit parashihet në Kodin e Rrjetës (Kodi i Balancit) në fuqi sepse:

- Rregullat e përkohshme të tregut nuk e përfshijnë mekanizmin balancues

- Nuk ka burime të mjaftueshme të rezervës balancuese
- Nuk është nënshkruar ndonjë marrëveshje specifike për shërbime balancuese
- Nuk është nënshkruar ndonjë marrëveshje specifike për shërbime balancuese

### Nga obligimet e shërbimeve ndihmëse të kërkuara në Kodin e Balancit realizohen:

- Rregullimi Primar që kryhet nëpërmjet njërive generuese të KEK
- Rregullimi Sekondar deri në maj 2008 është blerë nga EPS (Elektro Privreda Serbije) sipas marrëveshjes së vitit 2001 në mes të UNMIK dhe Ministrisë së Energjisë së Serbisë, dhe nga qershori 2008 obligimet e marrëveshjes kanë kaluar tek EMS (TSO e Serbisë)

- Rregullimi i ngadalshëm terciar kryesisht realizohet nëpërmjet reduktimit të konsumit

Balancues Regional, vendim që duhet marrë pas konsultimeve me Palët e interesit (KEK, Qeveri, Rregullator), treg i cili nëse vihet në funksion mund të jetë si një mundësi shtesë i tregut të brendshëm të balancimit që duhet të vendoset në një të ardhme të afërt.

Në kohën e fundit në adresë të KOSTT ka arritur ftesa për deklarimin për bashkëngjitje në formimin e Tregut




Fig.18. Mesatarja e devijimeve orë për orë për vitin 2008




Fig.19. Krabasimi i jobalancave negative dhe pozitive për vitin 2008 nëpër orë

## Transiti i energjisë elektrike, shfrytëzimi i kapaciteteve të interkoneksionit dhe problematika që e shoqëron

Transiti i energjisë elektrike është shfrytëzimi i infrastrukturës së një TSO-je nga një apo më shumë TSO për transimion të energjisë elektrike. Transiti i energjisë elektrike duke shfrytëzuar infrastrukturën e një TSO tjetër shkakton humbje shtesë si në këndvështrimin e humbjeve të energjisë ashtu edhe në koston e infrastrukturës.

Udhëzimi nr. 2003/54/EC përshkruan rregullat e përgjithshme të tregut të brendshëm evropian, ndërsa dispozitat e përgjithshme sa i përket qasjes në transimion dhe tregtisë ndërkufitare (transitit) përfshihen në rregulloren nr. 1228/2003 të Bashkimit Evropian.




Fig.20. Krabasimi i konsumit të brendshëm dhe transitit




Fig.21. Të hyrat e simuluar të KOSTT sipas metodologjive të ndryshme.

Faturimi i transitit sipas metodologjisë “By LawEKC”– KOSTT nga korriku 2004 nuk është kompensuar për koston e shkaktuar nga transiti. Kështu duke u bazuar në marrëveshjen e ish-elektroekonomive të ish-Jugosllavisë ku Elektroekonomia e Kosovës ka qenë palë e barabartë, është llogaritur kostoja e transitit nëpër territorin e Kosovës, dhe sasia e tillë i’u ka faturuar EMS (TSO e Serbisë), pasi që EMS-i ka qenë përfitues i pagesës së transitit edhe për Kosovën, duke u bazuar në ITC mekanizmat prej korrikut 2004 e gjer më sot. Kalkulimi është bërë sipas formulës së mëposhtme, ndërsa në tabelë është paraqitur vlera e kompensimit për periudhën korrik 2004 – dhjetor 2008 e cila i’u është faturuar EMS-it.

$$Pagesa = \{\min(EF, IF)\} \times \left\{ 31.5 \left[ \frac{\text{Euro}}{\text{MWh}} \right] \right\} \times \{1.5\%\} \times \left\{ \frac{118}{100} \right\}, \text{ ku EF janë rrjedhat eksport dhe IF rrjedhat import}$$

A	B	C	D	E	F
Muaji	Transiti [MWh]	Çmimi [€/MWh]	Shtegu i tran. [km]	Kompensimi [%]	Pagesa EXBXCX(D/100)
2004	1,449,548	31.50	118	1.50	808,195.49 €
2005	3,121,403	31.50	118	1.50	1,740,338.24 €
2006	2,905,603	31.50	118	1.50	1,620,019.21 €
2007	3,211,636	31.50	118	1.50	1,790,647.65 €
2008	3,297,511	31.50	118	1.50	1,838,527.26 €
Gjithsej					7,797,727.85 €

Tabela 6. Faturimi i transitit sipas metodologjisë “By LawEKC” për periudhën korrik 2004 – dhjetor 2008

Aktivitetet e deritanishme të ndërmarra nga KOSTT për të zgjidhur këtë problematikë, që i referohet jo vetëm transitit por edhe alokimit (ndarjes) së kapaciteteve transmetuese në linjat e interkoneksionit me sistemet fqinje pas shumë përpjekjeve për zgjidhje miqësore, përfshijnë:

- Ankesën zyrtare pranë Zyrës së Sekretariatit të Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore, si një e drejtë që buron nga vetë Traktati dhe
- Pjesëmarrja e rregullt e KOSTT në grupet punuese për ITC RG 2010, si dhe në nëngrupet e tjera të SETSO në cilësi të vëzhguesit jo si palë plotësisht e barabartë me TSO e tjera.

Anëtarësimi i KOSTT në asociacionet ndërkombëtare të operatorëve të transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike me automatizëm do të siguronte pjesëmarrjen e KOSTT në të gjithë mekanizmat rajonale dhe evropiane dhe përfundimisht do të zgjidhte problemet dhe marrëdhëniet me Serbinë.

# Bashkëpunimi ndërkombëtar

Edhe në vitin 2008, KOSTT ka vazhduar me pjesëmarrje aktive në trupat relevante regjionale duke thëlluar bashkëpunimin me akterët relevante dhe me kompanitë simotra në vendet e tjera. Objektiv i mëtutjeshëm i KOSTT mbetet anëtarësimi në ENTSO-E<sup>2</sup>, asociacion ky në formim e sipër në të cilin do t'i shkrijnë veprimtaritë e tyre UCTE<sup>3</sup>, ETSO<sup>4</sup>, SETSO TF<sup>5</sup> dhe disa asociacione tjera.

Gjatë këtij viti KOSTT mori pjesë aktive në nëngrupet punuese të SETSO TF, në mënyrë të veçantë në nëngrupin për menaxhim të kongestionit i cili teston mekanizmin për alokim të koordinuar të kapaciteteve. Qëllimi kryesor i pjesëmarrjes së KOSTT është futja në modelin testues (dry-run) për alokim të kapaciteteve të linjave ndërkufitare. Në këtë aspekt KOSTT ka bërë aplikimin formal dhe duke qenë vazhdimisht i penguar nga operatori serb, ka kërkuar edhe qëndrimin e Komisionit Evropian, i cili ka qenë pozitiv për KOSTT por që në praktikë nuk është implementuar ende nga SETSO TF. Në anën tjetër KOSTT duke qenë pjesëmarrës aktiv në SETSO TF dhe Grupin Implementues të CAO<sup>6</sup> ka arritur suksese të mëdha, fillimisht në aspektin politik, duke lobuar në përfshirjen e Kosovës në regjionin e 8<sup>7</sup>, dhe më pas edhe me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit<sup>8</sup> për themelimin e CAOs.

Me qëllim të përfshirjes në mekanizmin e ardhshëm të kompensimit të transitit, KOSTT ka marrë pjesë aktive edhe në Grupin Referues të ETSO-s për ITC<sup>9</sup> pas 2010, qëllimi i të cilit është asistimi në përpilimin e mekanizmit pan-evropian për kompensim të transitit. Krahas këtyre aktiviteteve KOSTT ka shqyrtuar mundësitë për anëtarësim në ETSO dhe UCTE, objektiv ky që edhe më tutje vazhdon por që tashmë i referohet ENTSO-E. Për të realizuar këtë qëllim KOSTT ka përpiluar projekte të cilat priten t'i implementojë për përmbushjen e kriterëve teknike të cilat kërkojnë.

Në aspektin e planifikimit dhe zhvillimit të rrjetit, edhe gjatë vitit 2008, KOSTT ishte pjesëmarrës aktiv në grupin regjional SECI<sup>10</sup>, qëllimi i të cilit është harmonizimi i investimeve në rrjetin transmetues. Bashkëpunim më i intensifikuar ishte me TSO-të fqinje, e sidomos me TSO-në e Shqipërisë me të cilën u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunim dhe Marrëveshja ndër-TSO<sup>11</sup>. Rezultatet nga bashkëpunimi me TSO-të fqinje priten në 2009, kur synohet nënshkrimi i marrëveshjeve edhe me kompanitë simotra të Malit të Zi dhe Maqedonisë.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se në proceset dhe integrimet regjionale KOSTT është ballafaquar me shumë vështirësi, të cilat kanë ardhur si rezultat i vazhdueshëm i pengesave dhe obstrukcioneve të operatorit serb, por edhe vetë Serbisë si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Siç është cekur në shumë raporte këto pengesa po i shkaktojnë një dëm të madh KOSTT dhe në përgjithësi industrisë elektroenergjetike të Kosovës. Sipas vlerësimeve të KOSTT ky dëm implikon një kosto prej €15 Mil në vit, barrë të cilën e bartin konsumatorët e Kosovës. Si rezultat i kësaj në gusht të 2008, KOSTT ka dorëzuar Ankesë formale në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë kundër Serbisë si palë kontraktuese<sup>12</sup>. Lënda e Ankesës i referohet abuzimit të Ligjit të Komunitetit të Energjisë nga Serbia në implementimin e Rregullores 1228/2003 për qasje në rrjet dhe tregti ndërkufitare. Rezultatet nga ankesa priten në 2009.

<sup>2</sup> Rrjeti Evropian i OST-ve (European Network of Transmission System Operators for Electricity), i cili themelohet dhe mandatohet nga Komisioni Evropian si zëri i përbashkët i OST-ve të Evropës. Qëllimi i këtij asociacioni do të jetë intensifikimi i bashkëpunimit dhe përgatitjet për implementimin e pakos së tretë ligjore të Energjisë, e cila është në përpilim e sipër. Në këtë asociacion do të shkrihen asociacionet Evropiane dhe regjionale si; UCTE, ETSO/SETSO TF, Nordel, UKTSOA, BALTSO, ATSOI.

<sup>3</sup> Unioni për Co-ordination of Transmission of Electricity - Unioni për Koordinim të Transmisionit të Energjisë Elektrike.

<sup>4</sup> European Transmission System Operators TSO-t - Asociacioni i OST-ve të Evropës.

<sup>5</sup> Southeast European TSOs Task Force - Trupi Veprues i OST-ve i EJT i cili vepron nën ombrellën e ETSOs.

<sup>6</sup> Coordinated Auction Office Implementation Group - Grupi Implementues për themelimin e Zyrës regjionale për Alokim të Koordinuar të Kapaciteteve i themeluar në 2007, ku marrin pjesë OST-të dhe rregullatorët e regjionit.

<sup>7</sup> Në Qershor 2008, Këshilli i Ministrorëve të Komunitetit të Energjisë mori vendimin për implementimin e vendimit të Komisionit Evropian të Nëntorit 2006 që ndryshon Aneksin e Rregullorës 1228/2003. Ky vendim u bë obligativ për regjionin e EJT, i ashtuquajtur regjionin i 8, pjesë e të cilit u bë edhe Kosova, si nënshkruese e Traktatit.


<sup>8</sup> U nënshkrua në Dhjetor 2008 në mes OST-ve të regjionit të 8, si pjesë e procesit për themelimin dhe funksionalizimin e CAOs. Pala Serbe nuk e nënshkroi për faktin se KOSTT ishte nënshkruese e Memorandumit.

<sup>9</sup> Inter TSO Compensation - mekanizmi për kompenzim ndër-OST në zhvillim e sipër për përditësimin 2010 e tutje.

<sup>10</sup> Southeast Europe Cooperation Initiative - Iniciativa e Evropës Juglindore për Kooperim

<sup>11</sup> Marrëveshja ndër-OST me Shqipërinë u nënshkrua në kohën kur raportohet, në fillim të 2009

<sup>12</sup> Palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë



## V. Projektet dhe investimet në Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës

## Plani i Zhvillimit të Rrjetit të Transmisionit

Rrjeti i Transmisionit të Kosovës ka nevojë për zhvillim të konsiderueshëm për ta sjellë atë në kushte që mund të operojë me besueshmëri dhe siguri për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve pa pengesa dhe kufizime të paarsyeshme. Kushtet e tanishme të rrjetit të energjisë elektrike në Kosovë janë gjerësisht rrjedhojë jo vetëm e dëmtimeve të shkaktuara nga lufta e fundit, por gjithashtu edhe për mungesë kronike të investimeve gjatë dekadave të kaluara. Rezultati është rrjeti i vjetruar i cili nuk është i pajisur mirë për të plotësuar kërkesën maksimale të tanishme të sistemit të Kosovës, pavarësisht rritjes së ngarkesës së parashikuar në disa raporte.

Rrjeti nuk përputhet me standardet e planifikimit të Kodit të Rrjetit. Në veçanti nuk plotëson kriterin N-1 të sigurisë sipas Kodit të Rrjetit. Sistemi i transmisionit dhe furnizimit me energji elektrike në Kosovë i ekspozohet këtij rreziku gjatë vitit, i cili konsiderohet i papranueshëm sipas standardeve ndërkombëtare. KOSTT do të ndër-marrë gjithë masat e arsyeshme për të kufizuar ndikimin e ndodhive (prishjeve) të tilla.

Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit (PZhST) i paraqitur për periudhën 2009-2013 do të zhvillohet në drejtim të eliminimit të këtij rreziku.

Implementimi i PZhST-së ngrit kualitetin e shërbimeve të KOSTT si operator i tregut, operator i sistemit dhe pronar i aseteve të transmisionit dhe kjo është një sfidë që kërkon aplikimin e prioriteteve përmbajtjesore dhe logjike.

Vlera totale e PZhST-së 2009-2013 parashihet të jetë 219.363.000 €, që identifikojnë katër grupe të projekteve :

1. Projektet që i ndihmojnë KOSTT në përforsimin e rrjetit të transmisionit, vlera e të cilave parashihet të jetë 115.939.000 €;
2. Projektet që përfshijnë renovimin e sistemit të transmisionit, vlera e të cilave parashihet të jetë 30.896.000 €;
3. Projektet që përfshijnë realizimin e monitorimit, kontrollit matjet si dhe shërbimet ndihmëse me qëllim që KOSTT të plotësojë rolin si operator i sistemit dhe i tregut, vlera e të cilave parashihet të jetë 31.212.000 €;
4. Projektet me të cilat realizohet përkrahja e konsumit distributiv-nënstacionet e reja 110/x/kV, vlera e të cilave parashihet të jetë 41.817.000 €.

Nga tërë kërkesat e investimeve sipas 1,2 ose 3 afërsisht 2/3 janë të siguruara, zotuar dhe të premtuara si grante dhe një shumë prej rreth € 17 Mil në formë huaje komerciale nga donatorët si Buxheti i Konsoliduar i

Kosovës, Komisioni Evropian, Qeveria gjermane nëpërmjet bankës zhvillimore KfW. KOSTT vlerëson me shumë respekt këto financime deri në momentin e arritjes së vetëqëndrueshmërisë financiare.

Nga tërë kërkesat e investimeve sipas 1,2 ose 3 afërsisht 2/3 janë të siguruara, zotuar dhe të premtuara si grante dhe një shumë prej rreth 17 milionë euro në formë huaje komerciale nga donatorët si Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, Komisioni Evropian, Qeveria gjermane nëpërmjet bankës zhvillimore KfW. KOSTT vlerëson me shumë respekt këto financime deri në momentin e arritjes së vetëqëndrueshmërisë financiare.

## Projektet dhe investimet në Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës

Duke pasur parasysh se KOSTT sh.a është përgjegjës për planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë, gjatë vitit 2008 edhe viteve të tjera prej themelimit, KOSTT sh.a ka qenë maksimalisht i përkushtuar për përmbushjen e objektivave që dalin nga Plani i Biznesit 2008, në zhvillimin dhe implementimin e shumë projekteve investuese kapitale, projekte këto që ndikojnë direkt në rritjen e kapaciteteve transmetuese, duke eliminuar fytet e ngushta, menaxhimin me efikas të sistemit elektroenergetik, rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit transmetues, rritjen e saktësisë së matjeve komerciale, zvogëlimin e humbjeve teknike në rrjet, përmirësimin e profilit të tensionit, i cili reflekton në kualitet të lartë të furnizimit dhe mundësimin për përkrahjen e zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik dhe industrial të vendit.



## Investimet në avancimin e Sistemit të Transmisionit

Investimet në Sistemin e Transmisionit pas luftës kanë qenë të përqëndruara në plotësimin e boshllëkut të investimeve, për një periudhë 10 vjeçare, periudhë kjo e administruar nga pushteti i dhunshëm serb.

Investimet gjatë viteve 1999 – 2006 më shumë kanë qenë të përqëndruara në përkrahjen e ngarkesës distributive në vlerë diku më se €14 Mil, kurse pjesa tjetër e investimeve ka qenë e përqëndruar në ngritjen e kapaciteteve të transmisionit (më se €5.5 Mil) dhe ngritjen e sigurisë

dhe besueshmërisë së sistemit (më se €4 Mil).

Pas themelimit të KOSTT me 1 korrik 2006, investimet kanë shtuar hov dhe për periudhën 2006 – 2008 më se €22 Miljanë të realizuar në ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit, €10.2 MIl në ngritjen e kapaciteteve transmetuese dhe më se €9 Mil në përkrahjen e ngarkesës distributive.

Në kuadër të projekteve investuese është planifikuar të ndërtohet edhe linja interkonektive 400 kV, Kosovë – Maqedoni.

## Projektet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2008

#	Projekti	Vlera e Kontrates	Buxheti i Planifikuar 2008	Buxheti i Realizuar 2008	Viti Planifikuar Përfundimit
1	Shërbimi konsulent për projekt & Paket Projekti TS 400/110 kV – Peja 3	23,343,233	10,250,000	7,500,000	2010
2	Shërbimi konsulent për projekt & Rehabilitimi i NS Kosova A	10,334,073	7,104,000	7,104,000	2010
3	Shërbimi konsulent për projekt & SCADA/EMS & Telekomit	17,981,680	6,150,000	5,265,900	2011
4	Njehsorët e KOSTT-it	2,071,783	1,400,000	840,000	2009
5	Ndërimi i Mbrojtjeve Rele dhe SKT në TS Prishtina 4 dhe NS Kosova B	2,049,086	820,000	820,000	2008
6	Ndërimi i NF 110 kV, TS Prishtina 1 dhe TS Prishtina 2	497,980	45,000	43,000	2008
7	Ndërimi i Përçuesve në LP 110 kV, TS Kosova A – TS Vushtrri 1 dhe TS Prizreni 1 – TS Prizreni 2	1,188,297	532,521	532,521	2008
8	Ndërimi i LP 110 kV Rahoveci	3,347,700	1,085,400	1,170,000	2008
9	LP By pass Mitrovica	1,363,000	1,363,000	1,363,000	2008
<b>TOTAL:</b>		<b>62,176,832.0</b>	<b>28,749,921.00</b>	<b>24,638,421.00</b>	




Fig.22. Projektet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2008





## Rezultatet e arritura 2008

Gjatë vitit 2008 janë realizuar projekte investuese në vlerë prej më se €26 Mil, projekte këto që ndahen si projekte njëvjeçare dhe shumëvjeçare. Duhet theksuar se pjesa e projekteve që mbulohet nga Buxheti i Kosovës është realizuar 100 %, ndërsa nëse krahasohet në planifikimin e tërë të investimeve sipas Aplikacionit të Tarifave janë realizuar më se 68 %.

Ky mosrealizim i 100 % i projekteve është si pasojë e implementimit të projekteve në periudhë më të gjatë (2-3 vjeçare), siç janë: Paket projekti NS Peja 3, rehabilitimi i NS "Kosova A", SCADA/EMS dhe Telekomit si dhe mos zotimi në kohë sipas planit i mjeteve nga donatorët për projektet, si dhe mos zotimi i mjeteve financiare për projektet e ndërtimit të nënstacioneve 110 kV.



## VI. Organizimi i brendshëm dhe kapacitetet njerëzore

KOSTT është i përkushtuar në krijimin e një ambienti të sigurt për punë dhe të jetë një punëdhënës atraktiv për punëtorët e tij. KOSTT më 1 korrik 2006 ka filluar punën me 157 punëtorë dhe shumë shpejt ka funksionalizuar skemën e re organizative ku janë definuar qartë përgjegjësitë dhe obligimet e të gjithë punonjësve.

Ky numër i punëtorëve është rritur gradualisht në përputhje me nevojat e kompanisë dhe KOSTT tani numëron 201 punëtorë, prej të cilëve 50% janë me përgatitje superiore profesionale, 38% janë inxhinierë.




Fig.23. Struktura organizative e funksioneve në KOSTT



## Të dhënat e burimeve njerëzore të KOSTT për vitin 2008

Numri i të punësuarve në KOSTT			
Numri i të punësuarve në KOSTT më datën 31.12.2008			201
Numri i të punësuarve në KOSTT gjatë vitit 2007			191
Numri i rritur i të punësuarve gjatë vitit 2008		10 punëtorë më tepër ose 5 %	
Struktura e të punësuarve sipas gjinisë			
Meshkuj			159 ose 79.10%
Femra			42 ose 20.90%
Struktura kualifikuese e punonjësve			
PSP (përgatitje superiore profesionale)	100	M F	73 ose 36.32% 27 ose 13.43%
PL (përgatitje e lartë)	4	M F	4 ose 1.99%
KL (kualifikimi i lartë)	11	M F	11 ose 5.47%
PMP (përgatitje e mesme profesionale)	81	M F	70 ose 34.82% 11 ose 5.47%
PK (Pa kualifikuar)	5	M F	1 ose 0.49% 4 ose 1.99%
Struktura sipas profesionit me PSP			
Inxhinier			77 ose 38.30%
Ekonomist			14 ose 6.96%
Jurist			7 ose 3.48%
Fakulteti i Filologjisë / gjuhë shqipe			2 ose 0.99%
Mosha mesatare e të punësuarve në KOSTT			43 vite

Tabela 7. Të dhënat e burimeve njerëzore të KOSTT për vitin 2008



## Ngritja e kapaciteteve të ekspertizës në KOSTT

KOSTT sh.a i kushton rëndësi të madhe ngritjes së ekspertizës profesionale të punonjësve e cila është, po ashtu, edhe një nga objektivat strategjike të kompanisë. Në kuadër të kësaj, KOSTT sh.a gjatë vitit 2008 ka realizuar trajnime në vlerat si më poshtë:

Investime për kurse dhe trajnime gjatë vitit 2008	€ 76,772.66
Pjesëmarrjet ne grupe punuese të Evropës Juglindore	€ 56,214.49
Publikimet dhe literatura profesionale gjatë vitit 2008	€ 2,457.14
Implementimi i trajnimeve dhe udhëtimeve zyrtare, siç janë ato për pjesëmarrje në grupe punuese të regjionit	€ 135,444.29
Numri i punëtorëve që kanë kaluar në trajnime	109
Ditë trajnim të realizuara	659
ditë/punëtor/trajnim	3.28

*Tabela 8. Vëllimi i trajnimeve dhe udhëtimeve zyrtare, siç janë ato për pjesëmarrje në grupe punuese të regjionit të implementuara gjatë vitit 2008*



## VII. Tarifat e shfrytëzimit të shërbimeve të transmisionit dhe pasqyrat financiare

Të hyrat e lejuara vjetore të KOSTT i cakton Zyra e Rregullatorit për Energji - ZRrE, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Metodologjinë e Tarifave dhe Rregullën e Çmimeve.

Bordi i ZRrE me Vendimin D\_108\_2008 të datës 03.07.2008 ka miratuar tarifat e reja për KOSTT, të cilat filluan të aplikohene nga 1 qershor 2008.

Të hyrat e lejuara janë në emër të tarifave për shfrytëzimin e infrastrukturës për transmetimin dhe shpërndar-

jen e energjisë elektrike, operimin e sistemit dhe operimin e tregut. Këto të hyra do të shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve operative dhe kostosë kapitalit.

Struktura e të hyrave të lejuara duket si vijon:

- Të hyrat nga infrastruktura e rrjetit 400/220 kV
- Të hyrat nga infrastruktura e rrjetit 110 kV
- Të hyrat nga operatori i sistemit
- Të hyrat nga operatori i tregut

Grupi Tarifor	Niveli i Tensionit të Kyçjes	Elementet Tarifore	Njësia	E aprovuar viti 2008
Gjenerimi	400 kV / 220 kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Gjenerimi	110 kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Gjenerimi	Shpërndarja (Distribucioni)	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.289
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Furnizimi	400 kV / 220 kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW	3.618
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Furnizimi	110 kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW	7.878
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013

Tabela.9 Tarifat e miratura për vitin 2008

## Metodologjia e Tarifave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit

Në bazë të Nenit 4.3 (l) dhe (m) si dhe në bazë të Nenit 6.7 të Kodit të Kyçjes, KOSTT ka përgatitur dhe ZRrE ka miratuar dokumentin Metodologjia e Tarifave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit .

Ky dokument trajton çështjet si vijon:

1. Trajtimin dhe parimet e tarifave për kyçjet e reja në rrjetin e transmisionit

2. Definimin e asetëve direkte, përfshirë këtu edhe asetet që ndahen në ato për shfrytëzim të përgjithshëm të sistemit dhe për shfrytëzim direkt
3. Ndarjen e kostos (shpenzimeve) së asetëve direkte
4. Qasjen në kalkulimin e tarifës
5. Qasjen në detyrimin për mirëmbajtje dhe operim
6. Ofertën për kyçje dhe Marrëveshjen për Kyçje
7. Anulimin e kyçjes; dhe
8. Ankesat



## Parimet e Tarifimit

Në mënyrë që të përmbush të gjitha kërkesat ligjore si dhe sugjerimet e arsyeshme nga palët e involvuara, KOSTT ka paraqitur Metodologjinë e Tarifave për Kyçje pjesërisht të thellë ose të ashtuquajtur modelin hibrid për tarifimin e kyçjes së re në Sistemin e Transmisionit për sa i përket ngarkesës dhe kyçje e thell për gjenerim. Për qëllim të implementimit, palët që ndryshojnë apo rrisin kapacitetin e tyre në kyçjet ekzistuese, sipas disa standardeve të caktuara do të kenë trajtimin e njëjtë dhe kjo metodologji do të jetë plotësisht e zbatueshme.

Para përshkrimit të modelit hibrid, është dhënë kuptimi i tarifës së cekët dhe të thellë:

- a. **Me tarifë për kyçje të cekët (direkte), i kyçuri do të ngarkohet për të gjitha kostot e ndërlidhura me kyçjen e tij direkte. Do të thotë, do të paguaj vetëm kostot e ndërlidhura me prokurimin dhe instalimin e aseteve direkte, pavarësisht se kyçja kërkon përforcime të thella ose përforcim të infrastrukturës në sistem.**
- b. **Tarifa për kyçje të thellë (përforcime në infrastrukturë) përfshinë pagesën nga i kyçuri për të gjitha kostot e ndërlidhura me kyçjen, përforcimet direkte dhe të infrastrukturës.**

---

## Metodologjia Hibrid

Varësisht nga vendi ose specifikat e sistemit elektroenergetik, aplikohen tarifa dhe metodologji të ndryshme, plotësisht të thella, pjesërisht të thella, hibrid sipas parimeve të ndryshme, krejtësisht të cekëta, etj.

Metodologjia ndryshon në parimet e tarifës për kyçje sipas të cilave ngarkohen dhe paguhet nga Gjeneruesit (Gj) nga ato me të cilat ngarkohen dhe paguhet nga konsumi apo ngarkesa (N).

- **Gjeneratorët do të paguajnë tarifa për kyçje të thella, që do të thotë se do të paguajnë për të dy përforcimet, direkte dhe të infrastrukturës.**
- **Ngarkesa do të tarifohet si e thellë vetëm kur kyçja e tyre e planifikuar nuk është në përputhje me Planin Zhvillimor të Rrjetit të KOSTT. Në raste kur kyçja e ngarkesës është paraparë dhe është pjesë e Planit të aprovuar Zhvillimor të Rrjetit të KOSTT, do të aplikohet tarifa e cekët dhe i kyçuri do të financojë asetet direkte, kurse përforcimet do të financohen nga KOSTT përmes TUoS.**



# Pasqyrat financiare

Pasqyrat Financiare të KOSTT janë një paraqitje e strukturuar financiare, qëllimi i të cilave është për të ofruar informata rreth pozitës financiare, rezultateve të veprimtarisë dhe rrjedhës së parasë gjatë vitit 2008

Pasqyrat financiare të KOSTT sh.a janë të përgatitura në bazën e kostos historike në pajtim të plotë me Standardet Kosovare të Kontabilitetit-SKK, si dhe në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar-IFRS.

**Parimet e përgatitjes së pasqyrave financiare janë:**

- parimi aktual
- parimi i vazhdueshmërisë
- kuptueshmëria
- rëndësia dhe materialiteti
- besueshmëria
- qëndrueshmëria dhe krahasueshmëria

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në euro, e cila është valutë zyrtare në Kosovë.

## Raporti i Auditorit të Pavarur

Bordit të Drejtorëve të KOSTT Sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura të Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu “KOSTT Sh.a.” (Kompania), që përfshijnë bilancin e gjendjes më 31 Dhjetor 2008 dhe pasqyrën e operimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin që ka përfunduar dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese. Pasqyrat financiare të KOSTT sh.a. për fund vitin 31 Dhjetor 2007 janë të audituara nga një auditor tjetër me datë të raportit 8 Prill 2008, ka shprehur opinion të pakualifikuar për ato pasqyra financiare vetëm me një paragraf të theksimit të çështjes për pronësisë e patundshmërive.

### Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrolleve të brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të cilat janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të përshtatshme kontabël, si dhe realizimin e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

### Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim opinion mbi pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kemi bërë auditimin në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë përputhshmëri me kërkesat etike si dhe planifikimin dhe kryerjen e auditimit për të arritur siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë si rezultat i mashtrimit ose gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr parasysh kontrollet e brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin korrekt të pasqyrave financiare nga ana e entitetit në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit në efikasitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit. Auditimi po ashtu përfshinë vlerësimin e përshtatjes së politikave të përdorura kontabël si dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që neve i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të duhura të ofrojnë bazë për opinionin tonë.

*Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu, a Swiss Verein, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu and its member firms.  
Member of Deloitte Touche Tohmatsu*

## Opinion

Në opinionin tonë pasqyrat financiare të bashkangjitura prezantojnë realisht, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Kompanisë më 31 Dhjetor 2008, performanca financiare e saj dhe rrjedhjes së parasë po për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### Theksim i çështjes

Pa kualifikuar më tutje opinionin tonë ne tërheqim vëmendjen si në vijim:

- a. Siç është detajuar në shënimin 21 të këtyre pasqyrave financiare, një pjesë e madhe e statusit të patundshmërive të Kompanisë është ende e pazgjidhur gjerë me datën e këtijraporti.
- b. Siç është detajuar në shënimin 19 të këtyre pasqyrave financiare, Kompania më datë 31 Dhjetor 2008 ka kalkuluar humbje të tatueshme në vlerë prej EUR 6,514 mijë për tu bartur në të ardhmen si dhe humbje tatimore në vlerë prej EUR 414 mijë për fund vitin 31 Dhjetor 2008. Regullativa tatimore në Kosovë është në zhvillim e sipër dhe Kompanianuk ka pasur vlerësim tatimor nga Administrata Tatimore. Vlerësimi i Menaxhmentit për aktivitetet e kompanisë mund mos të jetë të njëjta me interpretimin e aktivitete të njëjta nga ana e Administratës Tatimore.

**Ky raport është përkthim i versionit origjinal në anglisht, në rast kontesti midis këtyre dy raporteve, përparësi ka ai në gjuhën angleze.**

Deloitte Kosova sh.p.k.  
Prishtinë, Kosovë

11 Mars 2009

**KOSTT SH.A.**  
**Bilanci i Gjendjes në Dhjetor 31, 2008**

	Notat	Në Dhjetor 31, 2008 ( në EUR 000)	Në Dhjetor 31, 2007 (në EUR 000)
<b>PASURITË</b>			
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>			
Pronat, Impiantet dhe Pajimet	4	43,295	30,717
Pasuritë e paprekshme	5	61	14
		<u>43,356</u>	<u>30,731</u>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Stoqet	6	1,257	1,213
Arkëtimet tregtare	7	7,576	5,081
Arkëtimet tjera	8	10,506	7,549
Arka dhe xhirollogaria	9	4,360	2,227
		<u>23,699</u>	<u>16,070</u>
<b>TOTAL PASURITË</b>		<u><b>67,055</b></u>	<u><b>46,801</b></u>
<b>KAPITALI DHE DETYRIMET</b>			
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar	10	25	25
Premiumi aksionar	11	28,347	28,332
Fitimi i mbajtur		3,853	643
		<u>32,225</u>	<u>29,000</u>
<b>Detyrimet jo-qarkulluese</b>			
Grantet e shtyera	12	30,038	14,100
<b>Detyrimet qarkulluese</b>			
Të pagueshmet tregtare dhe tjera	13	4,792	3,701
		<u>34,830</u>	<u>17,801</u>
<b>TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET</b>		<u><b>67,055</b></u>	<u><b>46,801</b></u>

Autorizuar për publikim nga menaxhmenti dhe nënshkruar në emër të tij në Mars 11, 2009

Z. Fadil Ismajli  
Drejtore Menaxhues

Z. Nebih Haziri  
Drejtore Financiar

**KOSTT SH.A.****Pasqyra e të Hyrave për vitin që përfundon në Dhjetor 31, 2008**

	Notat	Viti përfundon Dhjetor 31, 2008 (në EUR 000)	Viti përfundon Dhjetor 31, 2007 (në EUR 000)
<b>Të hyrat operative</b>			
Transmisioni i energjisë	14	15,212	10,483
Të hyrat tjera	15	647	480
		<b>15,859</b>	<b>10,963</b>
<b>Minus: Shpenzimet operative</b>			
Shpenzimet e personelit	16	1,982	1,485
Amortizimi	4-5	2,221	1,927
Riparimet dhe mirëmbajtja	17	1,144	1,109
Humbjet në transmision të energjisë		5,258	3,774
Shpenzimet tjera operative	18	774	804
Rregullimi sekondar		986	954
Shpenzimet e ujit, rrymës dhe telefonit		150	130
Shpenzimet për derivate dhe lubrifikante		83	77
Shpenzimet e materialit		51	93
		<b>12,649</b>	<b>10,353</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>3,210</b>	<b>610</b>
Tatimi në fitim	19	-	-
<b>FITIMI NETO GJATË VITIT</b>		<b>3,210</b>	<b>610</b>

**KOSTT SH.A.****Pasqyra e ndërrimeve në Ekuitet për vitin që përfundon në Dhjetor 31, 2008**

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Premiumi aksionar</b>	<b>Fitimi i mbajtur</b>	<b>TOTALI</b>
	----- <b>(në EUR 000)</b> -----			
Bilanci më 1 janar 2007	25	28,204	33	28,262
Fitimi gjatë vitit	-	-	610	610
Rritja gjatë vitit	-	134	-	134
Ndryshime tjera		(6)		(6)
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2007</b>	<b>25</b>	<b>28,332</b>	<b>643</b>	<b>29,000</b>
Fitimi gjatë vitit	-	-	3,210	3,210
Rritja gjatë vitit	-	15	-	15
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2008</b>	<b>25</b>	<b>28,347</b>	<b>3,853</b>	<b>32,225</b>

**KOSTT SH.A.****Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin që perfundon në Dhjetor 31, 2008**

Notat	Viti përfundon Dhjetor 31, 2008 (në EUR 000)	Viti përfundon Dhjetor 31, 2007 (në EUR 000)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi para tatimit	3,210	610
Rregullimet për:		
Amortizimi	4-5 2,221	1,927
Të hyrat nga interesi	15 (95)	-
Shlyerja e mjeteve themelore	4 12	-
Të hyrat nga grantet	12 (533)	(462)
<b>Fitimi operativ para ndryshimit në kapitalin punues</b>	<b>4,815</b>	<b>2,075</b>
Rritja në stoqe	(44)	(87)
Rritja në arkëtimet nga tregu	(2,495)	(4,257)
Rritja në arkëtimet tjera	(2,957)	(6,814)
Rritja në detyrimet tregtare dhe tjera	1,091	3,208
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>	<b>410</b>	<b>(5,875)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive</b>		
Interesi i pranuar	95	-
Blerja e mjeteve themelore	(12,157)	(593)
<b>Neto paraja e përdorur në aktivitetet investive</b>	<b>(12,062)</b>	<b>(593)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Grantet e pranuar	14,370	7,880
Grantet e kthyera	(585)	-
Neto kapitali i rritur	-	128
<b>Neto paraja nga aktivitetet financuese</b>	<b>13,785</b>	<b>8,008</b>
<b>Neto rritja e parasë dhe ekuivalenteve të parasë</b>	<b>2,133</b>	<b>1,540</b>
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	2,227	687
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit</b>	<b>4,360</b>	<b>2,227</b>

# Ngjarjet 2008 që kanë karakterizuar punën e KOSTT sh.a



**17 SHKURT** – Në ditën e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në ora 21:00, rrjeti transmetues i Kosovës ka transmetuar 967 MW energji, që shënon rekordin e transmetimit të energjisë elektrike të arritur ndonjëherë. Gjatë ditëve të shpalljes së pavarësisë, me qëllim të



mbështetjes, në KOSTT kanë qëndruar delegacioni i Republikës së Shqipërisë i kryesuar nga z.Ymer Balla, drejtor i përgjithshëm i Operatorit të Transmisionit të Shqipërisë si dhe z.Gjergj Bojaxhi, drejtor i përgjithshëm i Korporatës Energjetike të Shqipërisë.



**30 MAJ** – Komiteti Ekzekutiv i Institutit për Energji në Evropën Juglindore (IENE), me seli në Athinë, Greqi, ka emëruar Drejtorin menaxhues të KOSTT sh.a, z. Fadil Ismajli, anëtar të këtij instituti prestigjioz ndërkombëtar. z. Ismaili u emërua anëtar i institutit

**3 PRILL** – Është nënshkruar kontrata për implementimin e “Paket Projektit Peja 3”. Me “Paket Projektin Peja 3” i cili është i një rëndësie primare për rritjen e kapaciteteve transmetuese të Kosovës, parashihet ndërtimi i një nënstacioni të ri 400/110 kV (kilovolt) në afërsi të Istogut dhe ndërtimi i nënstacionit 110/10 kV në Skenderaj përfshirë dhe linjat ndërlidhëse 110 kV për NS Peja 1, NS Istog, NS Klina dhe NS Skenderaj.

**15 QERSHOR** – Hyn në fuqi Ligji i ri mbi ndërmarrjet publike Nr. 03/L-087, i cili ka ndryshuar strukturën korporative të KOSTT dhe të ndërmarrjeve tjera publike në Kosovë. Me këtë, ka pushuar edhe mandati i

IENE, si mirënjohje për kontributin e tij në promovimin e zhvillimit të sektorit të energjisë, nxitjen e vetëdijes për tregun e energjisë, kultivimin e bazës për investime, tregtim dhe zhvillim të energjisë.

**28 QERSHOR** – U nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të KOSTT sh.a dhe OST Shqipëri për projektin e ndërtimit të linjës interkonektive 400 Kv Kosovë-Shqipëri. Po ashtu, me këtë rast u nënshkrua edhe Memorandumi i Bashkëpunimit, për implementimin e projektit të rregullimit fuqi-frekuencë midis dy sistemeve elektroenergjetike.



**30 KORRIK** - Është përmbyllur me sukses projekti kapital për riparimin e tri linjave transmetuese 110 kV, linjës LP 125/1, që lidh nënstacionet NS Vushtrria 2 me NS “Kosova A”, LP 125/4 që lidh NS Vushtrria 2 me NS Vushtrria 1 si dhe të linjës LP 164/3 që lidh NS

Prizreni 1 me NS Prizreni 2. Me investimin kapital prej 1.188.297.30 euro për riparimin e linjave në fjalë, do të rritet siguria e furnizimit me energji elektrike, si dhe kapaciteti transmetues dhe konsumues për rajonin e Vushtrrisë, Mitrovicës, Burimit dhe Prizrenit.



**1 TETOR** - Ministrija e Energjisë dhe Minerave znj. Justina Shiroka-Pula vizitoi për herë të parë KOSTT sh.a ku shprehu interesim për projektet të cilat tani janë në implementim dhe të cilat do të ndikojnë në ngritjen e be-



sueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike, si dhe për nevojat e tjera për investime në rrjetin transmetues të Kosovës. KOSTT-i prezantoi para ministres Shiroka-Pula planin 7-vjeçar të investimeve.

**7 NËNTOR** - Filloi implementimi i projektit më të madh në 25 vitet e fundit në sistemin e transmisionit të Republikës së Kosovës. Vlera e “Paket Projektit Peja 3” i cili do të zgjasë 17 muaj është 23.3 milionë euro, prej të cilave 12.3 milionë € financohen në formë granti nga Qeveria e Gjermanisë dhe 11 milionë € financohen në formë granti nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

**26 NËNTOR** – Me iniciativën e KOSTT, akterët më kyç të sektorit të energjisë u mbledhën për të diskutuar rreth situatës aktuale në lidhje me tregtimin ndërkufitar të energjisë elektrike dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet KOSTT në proceset rajonale. Qëllimi i këtij takimi ishte bashkërenditja e veprimeve të të gjitha palëve të interesit, të cilat do të mund të krijojnë kushte të volitshme për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi, me të cilën do të evitoheshin pengesat e përbushjes së obligimeve të ristrukturimit të sektorit të energjisë elek-



trike, që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë ndaj së cilës Kosova ka detyrime, si palë nënshkruese.



**4 DHJETOR** - U bë inaugurimi i projektit - Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele dhe Sistemit Komandues dhe Monitorues - SCADA lokale në Nënstacionin 220/110 kV Prishtina 4. Projekti në vlerë prej 2.049.000 euro, i cili ka përfshirë edhe Ndërrimin e Mbrojtjeve Rele në Nënstacionin 400/220 kV – “Kosova B”, ka filluar implementimin në muajin qershor të vitit 2007 dhe sipas planit ka zgjatuar 18 muaj. Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

**11 DHJETOR** - Në takimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë në Tiranë, KOSTT sh.a, së bashku me shumicën e operatorëve rajonalë ka nënshkruar Memorandumin për themelimin e Zyrës së përbashkët rajonale për Alokim të Koordinuar të

kapaciteteve transmetuese interkonektive (Coordinated Auction Office). Ky proces konsiderohet të jetë një arritje e madhe për vendet e rajonit në procesin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike dhe integritimit në tregun e brendshëm të BE.

**23 DHJETOR** – Transformatori më i vjetër 220/110 kV në Sistemin Elektroenergetik të Kosovës, i cili është instaluar në nënstationin “Kosova A” para 45

vitesh, ka dalë nga puna pas prishjes. Sipas planit të mëhershëm, ky transformatorë së shpejti do të zëvendësohet.

**23 DHJETOR** – Është nënshkruar kontrata për projektin kapital-Sistemi komandues dhe monitorues SCADA/EMS dhe Telekom. Projekti kapital në vlerë totale prej 17.2 milionë euro është financuar plotësisht nga Buxheti i Kosovës. Implementimi i projektit do të fillojë në muajin janar të vitit 2009, dhe në total do të zgjasë 33 muaj. Me këtë projekt do të rritet siguria dhe besueshmëria e Sistemit Elektroenergetik (SEE) të Republikës së Kosovës, duke automatizuar sistemin elek-

trik si dhe do të mundësohet komandimi, monitorimi dhe në përgjithësi menaxhimi më efikas i SEE nga Qendra Dispeçerike Nacionale në KOSTT.



Përgatitja e Raportit Vjetor 2008 koordinuar nga:

**Naim Bejtullahu**  
**Zana Bajrami-Rama**

Hartuar nga:

**Arben Kllokoqi, Fllanza Xhelili, Gazmend Kabashi, Gonxhe Haziri, Ibrahim Gashi, Ilir Shala, Isak Kika, Kimete Fazliu, Merita Kostari, Naim Bejtullahu, Nasip Bresilla, Nebih Haziri, Nergize Reznici, Resmije Ahma, Safete Orana, Sahit Halimi, Sherif Dedaqi, Shkumbin Hysa, Shpresa Kursani, Ymer Neziri, Zana Bajrami-Rama**

Fotografitë

**Të gjitha fotografitë janë realizuar nga stafi i KOSTT**

**Operator Sistemi Transmisioni dhe Tregut - KOSTT sh.a**

Rr. Iljaz Kodra pn  
10000 Prishtinë  
Republika e Kosovës

Tel: + 381 (0) 38 501 601 5

Fax: + 381 (0) 38 500 201

E-mail: [info@kostt.com](mailto:info@kostt.com)

Web: [www.kostt.com](http://www.kostt.com)

**E shtypur në prill 2009**

**Publikimi nuk është për shitje**





[www.kostt.com](http://www.kostt.com)